

PERCEPTIMET, QËNDRIMET
DHE SFIDAT E TË RINJVE NË
MAQEDONINË E VERIUT

HULUMTIM PËR TË RINJTË DHE SIGURINË



osbe

Organizata për Siguri dhe
Bashkëpunim në Evropë
Misioni në Shkup

Perceptimet, qëndrimet dhe sfidat e të rinjve në Maqedoninë e Veriut

Hulumtim për të rinjtë dhe sigurinë



PËRMBAJTJA

1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1	HYRJE	9
1.2	ZBULIMET PARAPRAKE NGA HULUMTIMI	10
1.2.1	Perceptimi për sigurinë dhe mbrojtjen	10
1.2.2	Pjesëmarrja në proceset formale dhe joformale të paqes	11
1.2.3	Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit	11
1.2.4	Dhuna tek të rinjtë	12
1.2.5	Ngacimi kibernetik – Bullizmi kibernetik	13
1.2.6	Përfshirja dhe diskriminimi	14
1.2.7	Besimi tek autoritetet dhe njerëzit e tjerë dhe marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve	15
1.3	KONKLuzionET PARAPRAKE	16
1.4	REKOMANDIMET PARAPRAKE	18

2. METODOLOGJIA DHE FUSHA E HULUMTIMIT

2.1	QËLLIMI I HULUMTIMIT	21
2.2	METODOLOGJIA E HULUMTIMIT DHE KARAKTERISTIKAT E MOSTRËS	21

3. DEFINICIONET / PËRKUFIZIMET

3.1	TË RINJTË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT	23
3.2	SIGURIA DHE MBROJTJA	23
3.3	NGACIMI KIBERNETIK – BULLIZMI KIBERNETIK	24
3.4	DISKRIMINIMI	24
3.5	EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE RADIKALIZIMI QË SHPIE DREJT TERRORIZMIT	24
3.6	DHUNA	24

4. ANALIZA KONTEKSTUALE

4.1	ANALIZA E LEGJISLACIONIT	25
	- Korniza ndërkombëtare	25
	- Korniza kombëtare	26
4.2	KORNIZA STRATEGJIKE DHE PROGRAMORE	29
4.3	MEKANIZMAT INSTITUCIONALE PËR PARANDALIM DHE MBROJTJEN NGA DHUNA	31

5. REZULTATET E HULUMTIMIT NË TERREN

5.1	PERCEPTIMI I SIGURISË DHE MBROJTJES	33
	- Nivelet e mbrojtjes dhe sigurisë në vend	33
	- Siguria dhe mbrojtja në vendbanime dhe vendet publike	35
	- Problemet më të mëdha aktuale të të rinjve	38
	- Shqetësimi i të rinjve për çështje të ndryshme	39
	- Përfundime dhe rekomandime	40

Titulli:	Perceptimet, qëndrimet dhe sfidat e të rinjve në Maqedoninë e Veriut
Përgatitur nga:	INDAGO DOOEL Shkup Boge Bozhinovski dhe Elizabeta Markovska Spasenoska
Botues:	Misioni i OSBE-së në Shkup
Përktheu:	INDAGO DOOEL Shkup
Lektura:	EUROLINGUA DOOEL Shkup
Dizajni grafi dhe shtypja:	POLYESTERDAY Gusht 2024

Materialet në këtë botim janë vetëm për referim. Edhe pse Misioni i OSBE-së në Shkup ka përkushtuar kujdesin më të madh në zhvillimin e tij, i njëjti nuk pranon asnjë përgjegjësi për saktësinë dhe plotësinë e informacioneve, udhëzimeve dhe këshillave të ofruara, apo për ndonjë gabim shtypi. Përmbajtja e këtij botimi, pikëpamjet, mendimet, gjetjet, interpretimet dhe konkluzionet e shprehura këtu nuk pasqyrojnë domosdoshmërisht politikën zyrtare ose qëndrimin e OSBE-së. Për këto arsye, asnjë pretendim nuk mund të bëhet kundër OSBE-së lidhur me pasojat e mundshme nga besueshmëria e informacioneve ose konkluzioneve të përfshira në këtë botim.

ISBN: 978-92-9271-384-3



5.2 Pjesëmarrja në proceset formale dhe joformale të paqes	41
– Njohuri të përgjithshme për konceptin e ndërtimit të paqes	42
– Aktivizëm rinor për paqe dhe siguri	43
– Aktivitetet e autoriteteve në lidhje me ndërtimin e paqes dhe sigurisë së të rinjve	45
– Përfundime dhe rekomandime	48
5.3 Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit	49
– Perceptimi i të rinjve për praninë dhe ndikimin e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm	49
– Roli i publikut dhe i institucioneve në parandalimin dhe reagimin ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit	51
– Përfundime dhe rekomandime	54
5.4 Dhuna tek të rinjtë	54
– Perceptimet e dhunës tek të rinjtë	55
– Eksperienca me dhunën	57
– Përfundime dhe rekomandime	60
5.5 Ngacmimi kibernetik – Bullizmi kibernetik	61
– Perceptimet e të rinjve për sigurinë në hapësirën digjitale	61
– Përvoja me cenimin e sigurisë dhe mbrojtjen në hapësirën digjitale	63
– Përfundime dhe rekomandime	66
5.6 Përfshirja dhe diskriminimi	67
– Perceptimet e të rinjve për diskriminimin	67
– Përvojë me diskriminim	68
– Pjesëmarrja e të rinjve në komunitetet lokale, shkollat/vendet e punës dhe me miqtë	69
– Përfundime dhe rekomandime	72
5.7 Besimi në autoritetet dhe të tjerët, si dhe marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve	73
– Perceptimet e besimit	73
– Qëndrimet për marrëdhëniet ndëretnike	75
– Besimi tek autoritetet	77
– Përfundime dhe rekomandime	78
6. Shqyrtimi i literaturës	80
7. Anekset	82
7.1 Pyetësor	82
7.2 Udhëzues për diskutim për fokus grupet	91
Pjesa 1: Perceptimet e sigurisë, përfshirja në aktivitetet e paqes dhe sigurisë	92
Pjesa 2: Diskriminimi, polarizimi politik, përjashtimi, dhuna	93
Pjesa 3: Radikalizimi, ekstremizmi i dhunshëm, marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve	94
Pjesa 4: Besimi tek institucionet dhe komuniteti	94
Pjesa 5: Rekomandime nga pjesëmarrësit	94

Gjatë mandatit tim si shef i Misionit të OSBE-së në Shkup, kam parë nga afër potencialin transformues të rinisë së Maqedonisë së Veriut. Roli i tyre kryesor në proceset shoqërore, nga nxitja e lëvizjeve shoqërore deri te inovacioni teknologjik dhe ndryshimet kulturore, është i pashembullt. Energjia, kreativiteti dhe qëndrueshmëria që përcaktojnë brezat e rinj ofrojnë një fener shprese për një të ardhme më të mirë.

Ky hulumtim nënvizon rolin proaktiv të të rinjve për të kontribuar në zgjidhjet e sigurisë. Ata nuk janë përfutës pasivë të vendimeve politike, por kontribuues aktivë me perspektiva unike dhe motivim të brendshëm për të nxitur ndryshime pozitive. Kjo i pozicionon ata si agjentë të domosdoshëm në përpjekjet tona kolektive për të ndërtuar shoqëri rezistente.

Për më tepër, ky hulumtim thekson fuqishëm rëndësinë kritike të përfshirjes së perspektivave të të rinjve në dialogun e sigurisë. Ata duhet të marrin pjesë në mënyrë aktive si kontribuues që mund të ofrojnë zgjidhje novatore për sfidat e sigurisë. Përfshirja e tyre në përpjekjet për ndërtimin e paqes, politikëbërjes dhe projekteve të komunitetit janë absolutisht vendimtare dhe të dobishme për sigurinë e qëndrueshme.

Shpresoj se ky hulumtim do të frymëzojë politikëbërësit, studiuesit, praktikuesit dhe të rinjtë që të përfshihen në dialog dhe veprim kuptimplotë drejt një shoqërie më të sigurt dhe më gjithëpërfshirëse. Vështrimet dhe rekomandimet brenda këtyre faqeve ofrojnë një udhërrëfyes për lundrimin në terrenin kompleks të të rinjve dhe sigurisë, duke hapur rrugën për një të ardhme ku të rinjtë lulëzojnë në një mjedis paqeje dhe stabiliteti.

Dëshiroj të falënderoj dhe të shpreh mirënjohjen time për të gjithë të rinjtë e përfshirë në përgatitjen e këtij publikimi, përfshirë palët e interesuara që morën pjesë në intervista dhe fokus grupe. Duke vepruar kështu, ju nuk jeni vetëm pjesë e ndryshimit pozitiv, por ju po e udhëhiqni atë.

Misioni i OSBE-së në Shkup mbetet i përkushtuar ndaj të rinjve të Maqedonisë së Veriut. Ne do të vazhdojmë të mbështesim përpjekjet që promovojnë politika që marrin parasysh nevojat dhe zërat e të gjithë elementeve të shoqërisë në përputhje me përkushtimet dhe vlerat e OSBE-së.

Ambasadori Kilian Wahl,
Shef i Misionit të OSBE-së në Shkup



1. PËRMBLEDHJE EKZEKUTIVE

1.1 HYRJJE

Misioni i OSBE-së në Shkup ka nënshkruar një marrëveshje me kompaninë kërkimore dhe konsultative, Indago Doel Skopje, për të kryer një studim përfaqësues në nivel shtetëror me qëllimet e mëposhtme:

1. Vlerësimi i perceptimeve, qëndrimeve dhe sfidave të të rinjve në lidhje me sigurinë në Republikën e Maqedonisë së Veriut;
2. Studimi i çështjeve dhe sfidave të sigurisë që përballen të rinjtë në kontekstin aktual shoqëror-politik;
3. Të shqyrtohen mënyrat se si të rinjtë ndikohen nga politikat e sigurisë dhe si mund të rritet praktika e pjesëmarrjes së tyre të rëndësishme në politikat dhe programet e sigurisë;
4. Studimi i burimeve të dhunës në mes të të rinjve, kontributi i tyre potencial në siguri dhe ndërtimi i rezistencës në komunitetet e tyre;
5. Studimi i faktorëve që ndikojnë në raportet ndëretnike dhe kohezioni mes të rinjve në vend;
6. Mbledhja e informacioneve që mbështesin planifikimin strategjik të Misionit.

Grupi i synuar për këtë hulumtim ishin të rinjtë në moshën 15 deri në 29 vjeç nga Republika e Maqedonisë së Veriut. Gjithsej 1,235 të anketuar janë përfshirë në mostrën e anketës telefonike. Përveç kësaj, ekipi i hulumtuesve kreu pesë (5) intervista gjysmë të strukturuar me palët e interesuara dhe tetë (8) diskutime me fokus grupe në qytetin e Shkupit (2 fokus grupe), në Manastir, Tetovë, Sveti Nikollë, Shtip, Strumicë dhe Strugë, duke përfshirë në total 63 pjesëmarrës. Anketa është zhvilluar gjatë periudhës nga 27 shtator deri më 10 tetor 2023, ndërsa diskutimet në fokus grupet janë mbajtur nga 4 deri më 26 tetor 2023.

Ky dokument paraqet zbulimet paraprake, konkluzionet dhe rekomandimet strategjike që dalin nga hulumtimi. Në mënyrë të detajuar, hulumtimi u përqendrua në perceptimin e të rinjve për sigurinë, pjesëmarrjen në proceset paqësore formale dhe joformale, statusin e të rinjve dhe agjendën e sigurisë, çështjet e kundërvënies dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në vend, dhunën ndaj të rinjve, përjashtimin dhe marginalizimin në të gjitha nivelet. Çdo njësi e këtyre fushave është elaboruar në seksionet e mëposhtme të këtij dokumenti.

1.2 ZBULIMET PARAPRAKE NGA HULUMTIMI

1.2.1 Perceptimi për sigurinë dhe mbrojtjen

Ky seksion analizoi perceptimin që kanë të rinjtë për nivelin aktual të sigurisë dhe mbrojtjes në vend, si dhe perceptimin e tyre për sigurinë në pesë vitet e ardhshme. Përveç kësaj, seksioni eksploroj opinionet e të rinjve për problemet më të mëdha të tyre dhe analizoi se sa të sigurt e gjejnë të rinjtë vendbanimin, vendin e tyre dhe lokacionet publike. Së fundi, ky seksion hulumtoi shqetësimet në lidhje me fenomenet e ndryshme që ndikojnë në sigurinë.

- Të rinjve iu kërkua të vlerësonin sigurinë në vend në një shkallë ku 1 do të thotë aspak e sigurt dhe 5 është plotësisht e sigurt. Vlerësimi mesatar i sigurisë është 3.4, që do të thotë as i sigurt dhe as i pasigurt. Pas kësaj, megjithëse shumica e të anketuarve (54%) e konsiderojnë vendin disi të sigurt ose plotësisht të sigurt (vlerat 4 dhe 5 në shkallë), ka ende 17% të të rinjve që e konsiderojnë vendin një vend jo të sigurt.
- Në lidhje me pritjet për sigurinë, të anketuarit janë pyetur për atë se çfarë do të ndodhë me nivelin e sigurisë në vend në pesë vitet e ardhshme. Shumica e të rinjve (56%) besojnë se situata do të mbetet e njëjtë, ndërsa mbi një e katërta (27%) besojnë se situata do të përkeqësohet.
- Të rinjve iu kërkua të zgjidhnin se sa të sigurt ndiheshin në vende të ndryshme. Lagjja është vendi më i sigurt për të rinjtë (81% ndihen të sigurt), ndërsa mjedisi digjital është më pak i sigurt (43% ndjehen të sigurt). Vajzat e reja ndihen më pak të sigurta në krahasim me djemtë e rinj.
- Sa i përket sigurisë në zonën/çytetin, shumica e të rinjve në rajonin verilindor, veçanërisht në çytetet e Kumanovës dhe Kriva Pallankës, (15%) ndihen të pasigurt në krahasim me rajonet tjera (nga 2% në 9%). Gjithashtu, sa i përket perceptimit të sigurisë në vend, një përqindje më e madhe e të rinjve nga ky rajon ndihen të pasigurt (32%), krahasuar me rajonet e tjera (nga 4% në 12%).
- Për sa i përket ndjenjës së sigurisë në vende publike, shumica e të rinjve ndihen pothuajse njësoj të sigurt në transportin publik (53%) dhe në sheshe publike, shtigje për ecje dhe korsi për biçikletë (54%). Megjithatë, përqindja e atyre që ndihen të pasigurt është pak më e lartë në transportin publik (11%) sesa në sheshet publike, shtigjet e ecjes dhe korsit për biçikletë (9%). Ndërsa shumica e të rinjve (57%) ndihen të sigurt në transportin publik, përqindja e vajzave të reja që ndihen të sigurta është më e ulët (48%).
- Mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive (51%) dhe mungesa e mundësive për zhvillim (51%) janë problemet më të mëdha të të rinjve për momentin, pasuar nga papunësia dhe problemet ekonomike, të cilat paraqesin problemet më të mëdha për 49% të të rinjve. Pothuajse një e katërta e të rinjve (24%) mendojnë se siguria në komunitetin e tyre është problemi më i madh për momentin.
- Të rinjtë janë më të shqetësuar për krimin e organizuar (vlera mesatare = 7.1 në një shkallë nga 1 deri në 10, ku 1 është më e ulëta dhe 10 është më e larta), të ndjekur nga fatkeqësitë natyrore (vlera mesatare = 6.9) dhe mundësia e shpërthimit të një konflikti të armatosur në Ballkanin Perëndimor (vlera mesatare = 6.7). Shqetësimi më i vogël tek të rinjtë lidhet me grupet e tifozeve që ndonjëherë janë të dhunshëm gjatë dhe pas ngjarjeve sportive (vlera mesatare = 5.7). Vajzat

e reja kanë vazhdimisht nivele më të larta të shqetësimit krahasuar me djemtë e rinj. Për sa i përket dhunës në familje, si një nga faktorët që kërcënon sigurinë, vajzat e reja janë dukshëm më të shqetësuara se djemtë e rinj.

1.2.2 Pjesëmarrja në proceset formale dhe joformale të paqes

Ky seksion hulumton mirëkuptimin e përgjithshëm midis të rinjve për ndërtimin e paqes, si dhe përvojat dhe pjesëmarrjen e tyre në aktivitete të ndryshme që lidhen me paqen dhe sigurinë. Gjithashtu, ky seksion analizoi veprimet e autoriteteve në lidhje me sigurinë e të rinjve.

- Njohuritë konceptuale dhe të kuptuarit e ndërtimit të paqes nga të rinjtë janë shumë të ulëta. Gjysma e të anketuarve nuk janë të njohur me konceptin e ndërtimit të paqes dhe vetëm 26% e të rinjve e kuptojnë këtë koncept. Ata të rinj që jetojnë në bashkësi multietnike janë më të ekspozuar ndaj aktiviteteve të ndërtimit të paqes dhe zgjidhjes së konflikteve dhe kështu bëhen më të njohur me këto koncepte.
- Duke ndjekur nivelet e ulëta të kuptimit të konceptit të ndërtimit të paqes, të rinjtë e intervistuar nuk tregojnë aktivizëm për pjesëmarrje në veprime dhe iniciativa që promovojnë paqen dhe sigurinë. Vetëm 6% e të rinjve ishin aktivë në 12 muajt e fundit në promovimin e paqes dhe sigurisë, kryesisht vullnetarë në ngjarje kulturore, aksione mjedisore, aktivitete arsimore formale dhe joformale dhe ngjarje sportive. Protestat civile dhe aktivitetet politike janë aktivitetet më të pakta për promovimin e paqes dhe sigurisë mes të rinjve.
- Shumica e të rinjve (87%) nuk kanë dëgjuar për aktivitetet e autoriteteve në lidhje me ndërtimin e paqes dhe sigurisë për të rinjtë.
- Organizatat civile janë zgjedhur nga pothuajse gjysma e të anketuarve (49%) si faktori/institucioni më i përfshirë në ndërtimin e paqes. Pas organizatave civile, renditen institucionet shtetërore (48%) dhe qytetarët (45%). Është interesant fakti që të rinjtë i vendosin përgjegjësitë për ndërtimin e paqes më së shumti në nivel nacional dhe me institucionet shtetërore, ndërsa pushteti lokal, i cili duhet të jetë shkalla e parë për sigurinë dhe paqen në komunitetet lokale, është vetëm në vendin e katërt (22%). Sa i përket kompetencave në nivel lokal, disa nga komunat kanë krijuar këshilla lokale për parandalim. Këshillat lokale për parandalim njihen si të rëndësishëm në politikat lokale të sigurisë dhe si të tilla duhet të kenë një rol të rëndësishëm, veçanërisht në mundësimin e një rrjedhjeje të shpejtë të informacionit ndërmjet aktorëve lokal dhe marrjen e veprimeve të shpejta për të përmirësuar sigurinë e qytetarëve.

1.2.3 Kundërvënja ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit

Sipas përkufizimit të OSBE-së, ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi që shpie drejt terrorizmit është "një proces dinamik me të cilin një individ e pranon dhunën terroriste si mënyrë e mundshme, ndoshta edhe legjitime, e veprimit. Eventualisht, mirëpo jo detyrimisht, kjo mund të çojë në atë që personi të përfaqësojë për terrorizëm, të veprojë në mbështetje të terrorizmit ose të përfshihet në terrorizëm." Ky seksion hulumton se sa të informuar janë të rinjtë për ekstremizmin e dhunshëm dhe radikalizimin. Përveç kësaj, seksioni shqyrton qëndrimet e të rinjve në lidhje me riintegrimin dhe risocializimin e personave të dënur, veçanërisht të ish-luftëtarëve.

- Shumica e të rinjve (53%) besojnë se radikalizimi nuk është një problem në komunitetin e tyre. Megjithatë, për 38% të të rinjve, radikalizimi është një shqetësim. Sipas përfaqësuesve të organizatave të të rinjve të intervistuar, ideologjia radikale nuk është gjerësisht e pranishme, por është e pranishme në vende dhe komunitete në territorin e vendit tonë.
- Politika është zgjedhur si faktori kryesor për radikalizimin nga 58% e të anketuarve, ndjekur nga dallimet ekonomike (40%) dhe religjioni (37%). Të rinjtë janë të vetëdijshëm për praninë e radikalizimit në hapësirën digjitale. 23% e të anketuarve besojnë se hapësira digjitale është një faktor i rëndësishëm për radikalizimin.
- Përgjithësisht, të rinjtë nuk janë të gatshëm të komunikojnë ose të jetojnë pranë njerëzve të dënuar për veprimtari terroriste/ekstremiste të dhunshme ose që tregojnë shenja të radikalizimit, ku 73% deri në 75% e të anketuarve pajtohen me këto deklaratë. Përveç kësaj, 43% e të anketuarve janë në mëdyshje nëse duhet të mbështesin riintegrimin e ish-luftëtarëve ose personave të dënuar për veprimtari terroriste dhe ekstremizëm të dhunshëm.
- Pothuajse dy të tretat e të rinjve (62%) besojnë se policia është aktori me rolin më të madh në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit, ndjekur nga organizatat ndërkombëtare (37%) dhe organizatat qytetare (33%). Roli i përfaqësuesve të shkollave dhe Qendrave për Punë Sociale në parandalimin dhe reagimin ndaj ekstremizmit të dhunshëm nuk është e njohur mjaft mirë nga të rinjtë, pasi që vetëm një e katërta e të rinjve (26%) besojnë se këta aktorë kanë një rol të tillë. Në rajonin Jugperëndimor, strukturat qytetare (si organizatat qytetare, udhëheqësit fetarë dhe udhëheqësit e komuniteteve fqinje) dhe organizatat ndërkombëtare kanë një rol më të rëndësishëm në parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në krahasim me rajonet e tjera.
- Sipas 47% të të anketuarve, lufta kundër dezinformimit është faktori më i rëndësishëm si përgjigje ndaj radikalizimit, ndjekur nga mundësitë ekonomike dhe punësimi (44%) dhe shpërndarja e barabartë e mallrave dhe shërbimeve (40%).

1.2.4 Dhuna tek të rinjtë

Në kontekstin kombëtar, dhuna është definuar në kuadrin strategjik kombëtar si: "Të gjitha format e dhunës fizike dhe mendore, dëmtimeve ose keqpërdorimit, lënies në mëshirë ose moskujdesit, keqtrajtimit ose eksploatimit, duke përfshirë dhe shqetësimin seksual." Në këtë seksion, dhuna është analizuar në përgjithësi duke përdorur rezultatet e studimit hulumtues, me një fokus të veçantë në dhunën midis të rinjve në shkolla.

- Më shumë se gjysma e të rinjve (59%) deklarojnë se dhuna është "plotësisht e pranishme" ose "ndonjëherë e pranishme" në mesin e të rinjve, në krahasim me vetëm 11% që besojnë se dhuna "nuk është fare e pranishme" ose "është shumë pak e pranishme". Të tjerët 30% kanë qëndrime ambivalente lidhur me praninë e dhunës.
- Tri motivet kryesore që nxisin sjelljet e dhunshme te të rinjtë janë ndjenja e padrejtësisë (40%), zhgënjimi nga statusi social (39%) dhe mungesa e mbështetjes familjare (34%). Ata gjithashtu shumë afër e vlerësojnë edhe mungesën e mbështetjes institucionale (33%).

- Pothuajse një nga pesë të rinj (18%) i përfshirë në këtë hulumtim ka përjetuar ose ka qenë dëshmitar i dhunës, ose i të djave. Në mesin e atyre që kanë përjetuar dhunë, kryesisht kanë përjetuar ose kanë qenë dëshmitarë të dhunës verbale (80%) dhe fizike (74%). Dhuna fizike dominoi në deklaratimet e djemve të rinj, me 80% të përjetuesve ose dëshmitarëve të dhunës fizike në krahasim me 66% të vajzave të reja. Nga ana tjetër, dhuna verbale, sociale dhe psikologjike dominon tek femrat; 84% e vajzave të reja kanë përjetuar ose kanë qenë dëshmitare të dhunës verbale në krahasim me 76% të djemve të rinj. Po ashtu, përqindja e vajzave të reja që kanë përjetuar dhunë seksuale (4%) është dyfish më e lartë në krahasim me djemtë e rinj (2%).
- Edhe pse shumica e të rinjve ndihen të sigurt në ambiente publike, përvoja personale me dhunën dhe situatat e dhunshme në të cilat kanë qenë dëshmitarë janë shqetësuese. Shumica e të rinjve kanë përjetuar ose kanë qenë dëshmitarë të dhunës në rrugë (70%), më pas në shkollë (43%) dhe në parqe dhe bare (42%) në secilin lokacion. Në shumicën e vendeve të përfshira (7/12)¹ një përqindje më e lartë e vajzave të reja se sa e djemve të rinj kanë përjetuar ose janë dëshmitare të dhunës. Veçanërisht shqetësuese janë të dhënat për dhunën e përjetuar ose dëshmuar në shkollë. Për shembull, 81% e grupmohës nga 15 deri në 18 vjeç kanë përjetuar ose kanë qenë dëshmitarë të dhunës në ambiente shkollore, një fakt që vërteton se dhuna është prezente në një masë të madhe në shkollat fillore dhe të mesme.

1.2.5 Ngacmimi kibernetik – Bullizmi kibernetik

Bullizmi kibernetik është një formë specifike e dhunës, e cila përfshin sjellje të këqija, pakënaqësi, ose tallje me të tjerët duke dërguar ose postuar mesazhe apo imazhe ofenduese përmes kompjuterit ose telefonit celular. Mesazhet ofenduese ose imazhet mund të dërgohen përmes email-it, telefonit celular, mesazheve tekstuale, faqeve personale në internet si Facebook, TikTok, Instagram, Telegram, YouTube dhe hapësirave virtuale për biseda.

- Gati gjysma e të anketuarve (42%) në hulumtim ndihen "të sigurt" ose "plotësisht të sigurt" kur përdorin internetin, ndërsa 20% nuk ndihen të sigurt. Megjithatë, një përqindje relativisht e madhe e të anketuarve (38%) që ndihen "as të sigurt, as të pasigurt" mund të sjellë në përfundimin se nevojiten hulumtime të tjera për të hetuar arsyet pas kësaj situate dhe për të parë nëse nevojitet arsimimi shtesë për të rinjtë, për të rritur besimin dhe për të shprehur mendimet e tyre lidhur me sigurinë e tyre në internet.
- Shumica e të rinjve (66%) i kushtojnë vëmendje mbrojtjes së të dhënave të tyre personale dhe informacionit në internet. Megjithatë, 23% e të rinjve i kushtojnë dhe nuk i kushtojnë vëmendje mbrojtjes së të dhënave personale.
- Shumica e të anketuarve (72%) nuk kanë përvojë me përdorimin e fotove, videove ose të dhënave të tyre personale në internet pa miratimin e tyre. Të tjerët 24% njohin dikë që ka përjetuar këtë lloj dhune në internet.

¹ 12 lokacione të ndryshme publike u siguruan si alternativa përgjigjeje. Vajzat e reja kanë përjetuar dhunë në 7 nga 12 vende publike të dhëna në anketë.

- Edhe pse shumica e të rinjve në këtë studim (94%) nuk kanë përjetuar dhunë kibernetike, nga ata 77 të anketuar që kanë përjetuar dhunë kibernetike, 51% përballen me të rrjetin social Facebook, 23% në aplikacione për mesazhe të menjëhershme (siç janë për shembull Viber, WhatsApp, Telegram dhe Signal) dhe 19% në Instagram.
- Të rinjtë mund të identifikojnë ku të raportojnë dhunën kibernetike. Në pyetjen për institucionet/ instancat në të cilat do të raportojnë abuzimin e të dhënave personale dhe përmbajtjen, 38% do të raportojnë në policinë, 24% në familje dhe sërish 21% në Agjencinë për Mbrojtjen e të Dhënave Personale. Nga të rinjtë, vajzat e reja kanë më shumë besim në raportimin e dhunës kibernetike në familje (28%) krahasuar me djemtë e rinj (19%).

1.2.6 Përrjashtimi dhe diskriminimi

Në legjislacionin kombëtar, “diskriminimi është çdo dallim, përrjashtim, kufizim ose favorizim që bazohet në një bazë diskriminuuese, me veprim ose mosveprim, që ka për qëllim ose rezultat parandalimin, kufizimin, njohjen, përfitimin ose realizimin e të drejtave dhe lirive të një personi të caktuar ose grupi në një bazë të barabartë me të tjerët. Ky term përrfshin të gjitha format e diskriminimit, duke përrfshirë edhe pamundësinë e përrshtatjes përkatëse dhe pamundësinë e aksesit dhe qasje në infrastrukturë, në të mirat dhe shërbimet.” Ky seksion hulumton shkaqet më të zakonshme të diskriminimit ndaj të rinjve, përrvojën e tyre me diskriminimin dhe përrfshirjen e të rinjve në proceset vendimmarrëse.

- Sipas gati një të tretës së të anketuarve (31%) në hulumtim, e cilësojnë origjinën etnike si bazën kryesore për diskriminim në mes të të rinjve, ndjekur nga 21% e të intervistuarve që shohin statusin ekonomik si bazë kryesore për diskriminim, dhe 17% që shohin përkatësinë politike si bazë kryesore. 24% e të intervistuarve e kanë vlerësuar statusin ekonomik si bazë të dytë për diskriminim, pas së cilës vjen përkatësia politike dhe aftësia e kufizuar si baza e dytë e rëndësishme për diskriminim (15% e të intervistuarve për secilën bazë).
- Personalisht, 84% e të intervistuarve nuk kanë përjetuar ndonjëherë ose nuk kanë ndjerë diskriminim. Megjithatë, 11% prej tyre kanë përjetuar përvoja negative të diskriminimit. Një përrqindje pak më e madhe e vajzave të reja (12%) kanë përjetuar diskriminim në krahasim me djemtë e rinj (9%). Të rinjtë romë (32%) kanë përjetuar në një masë shumë më të lartë diskriminim në krahasim me 9% të të rinjve maqedonas dhe shqiptarë.
- Nga ata 11% të të rinjve që kanë përjetuar ose kanë ndjerë diskriminim, 33% kanë përjetuar diskriminim në bazë të origjinës etnike, ndjekur nga statusi ekonomik (19%) dhe përkatësia politike (13%).
- Edhe pse 11% e të rinjve kanë përjetuar diskriminim, vetëm 1% kanë kërkuar ndihmë nga autoritetet publike si Avokati i Popullit ose Komisioni për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi.
- Tre nga katër e të rinjve (75%) nuk janë të informuar për proceset e vendimmarrjes në komunitetin e tyre. 86% e të rinjve besojnë se ata janë praktikisht të pa përrfshirë në proceset

e vendimmarrjes në komunitetin e tyre. 86% e të rinjve besojnë se ata nuk mund të ndikojnë në vendimet në komunitetin e tyre. Një shqetësim i veçantë është se të intervistuarit nga rajoni i Pellagonisë shohin se ata nuk kanë asnjë influencë mbi vendimet që merren në komunitetin e tyre (99%).

- Dy të tretat e të rinjve (66%) nuk janë të informuar për proceset vendimmarrëse në ambientin e tyre shkollor ose të punës. 73% e të rinjve konsiderojnë se ata janë praktikisht të pa përrfshirë në proceset vendimmarrëse në shkollën ose ambientin e tyre të punës. 73% e të intervistuarve besojnë se ata nuk mund të ndikojnë në vendimet në shkollën ose ambientin e tyre të punës.
- Më shumë se gjysma e të rinjve (57%) ndjejnë se ata nuk janë të përrfshirë plotësisht në rrjetin e tyre shoqëror/grupet e miqve. 54% e të rinjve ndjejnë se ata nuk mund të ndikojnë në vendimet që merren në kuadrin e rrjeteve sociale/grupeve të miqve të tyre.

1.2.7 Besimi tek autoritetet dhe njerëzit e tjerë dhe marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve

Kjo pjesë hulumton nivelet e besimit të të rinjve në institucione, por edhe nivelet e besimit ndërmjet njerëzve dhe ndërmjet komuniteteve.

- Në lidhje me besimin në përrgjithësi, 48% e të rinjve të anketuar perceptojnë se shumicës së njerëzve mund t’u besohet ose nuk mund t’u besohet. Madje 35% mendojnë se “aspak nuk mund t’u besohet njerëzve në përrgjithësi” ose se “njerëzve nuk mund t’u besohet”.
- Shumica e të rinjve të anketuar (91%) kanë dikë të cilit i besojnë dhe do të kërkonin ndihmë në situata problematike. 85% e të rinjve të anketuar kanë miq të ngushtë. 82% e të rinjve kanë miq të cilëve mund t’u besojnë në kohë të vështirë.
- Të rinjtë kanë qasje të ndryshme ndaj besimit tek njerëzit nga komunitetet tjera etnike. Gjithsej, 57% nuk kanë besim në njerëzit nga komunitetet tjera etnike, ndërsa 43% kanë besim në njerëz me prejardhje etnike të ndryshme.
- Gjysma e të rinjve të anketuar vlerësojnë marrëdhëniet ndëretnike/ndërkomunitare si “as të mira as të këqija” (46%) dhe “të mira” (41%).
- Afërsisht dy e treta e të rinjve (62%) nuk pajtohen me deklaratën “Ndjehem i mbështetur nga njerëzit nga komuniteti im”. 61% e të rinjve pajtohen me deklaratën “Përrfshihem rregullisht në biseda me njerëz nga shumë fe/kultura dhe besime”.
- Besimi në institucione është në përrgjithësi i ulët dhe ndryshon nga 1.6 deri në 2.2 në një shkallë ku 1 është “aspak i besueshëm” dhe 4 është “tërrësisht i besueshëm”. Qeveria dhe liderët e partive politike (vlëra mesatare = 1.6) janë më pak të besueshëm, ndërsa gjykatat dhe Parlamenti (vlëra mesatare = 1.7) ndjekin pas. Niveli më i lartë i besimit është midis policisë, udhëheqësve fetarë dhe organizatave civile (vlëra mesatare = 2.2).

1.3 KONKLUZIONET PARAPRAKE

1. Një nga konkluzionet dominante që dalin nga analiza e kryer është se të rinjtë në shtet nuk kanë qëndrime të qarta për shumicën e çështjeve lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen e tyre. Ata e perceptojnë vendin (shtetin) as të sigurt, as të pasigurt. Sa i përket sigurisë në vend në pesë vitet e ardhshme, shumica e të rinjve mendojnë se gjendja do të mbetet e njëjtë, ndërsa më shumë se një e katërta e të rinjve konsideron se gjendja do të përqeshohet. Një qëndrim ambivalent mbizotëron në shumicën e çështjeve ndërmjet grupmoshave dhe grupeve etnike, si dhe në të gjithë rajonet e vendit. Ky zbulim tregon se të rinjtë nuk kanë informacion të mjaftueshëm për çështjet e sigurisë që do t'u ndihmonin atyre të shprehin qëndrimet e tyre. Gjithashtu, qëndrimi ambivalent mund të jetë rezultat i mangësisë së kuptimit dhe interesit për konceptet, politikat dhe praktikat kyçe, si dhe mungesës së përfshirjes së të rinjve në krijimin e politikave që lidhen me sigurinë dhe mbrojtjen e të rinjve.
2. Analiza e të dhënave nëpër rajonet statistikore zbulon tendencat specifike në disa rajone për pothuajse të gjitha çështjet lidhur me sigurinë dhe mbrojtjen. Për shembull, të rinjtë në rajonin Verilindor ndjehen më pak të sigurt dhe të mbrojtur, ndërsa ata në rajonin e Pellagonisë ndjehen të pashpresë në lidhje me ndikimin në procesin e vendimmarrjes në komunitetin e tyre. Në vazhdim, të rinjtë në rajonin Jugperëndimor shohin hapësirën digjitale si faktori më i rëndësishëm për radikalizimin, ndërsa ata në rajonin e Shkupit nuk kanë një qëndrim të qartë se cili është problemi kryesor i tyre. Të rinjtë në rajonin e Pollogut në një masë të konsiderueshme janë dëshmitarë ose kanë përjetuar dhunë. Këto specifika tregojnë se ekzistojnë mungesa dhe jokonsekuenca në qasjen strukturore të institucioneve dhe autoriteteve në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e të rinjve në nivel politik dhe operativ.
3. Të rinjtë vlerësojnë se institucionet në nivel kombëtar janë më të përgjegjshme për ndërtimin e paqes dhe sigurisë, ndërsa vetëqeverisja lokale, e cila duhet të jetë institucioni parësor në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen, është shumë më poshtë në listën e institucioneve të përgjegjshme. Kjo situatë reflekton hierarkinë e përgjithshme në vend, ku shumica e funksioneve janë të vendosura në nivel kombëtar. Për të ndryshuar këtë fokus tek të rinjtë, është e rëndësishme të vazhdohet procesi i formimit të Këshillave Lokale të Parandalimit si një hap shumë i rëndësishëm për rritjen e rolit të aktorëve lokal në sigurimin e një mjedisi të sigurt dhe për të diskutuar potencialin për rregullim ligjor të këtyre organeve.
4. Të rinjve u mungojnë informacione për shfaqjen e ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit në nivel shtetëror dhe për qëndrimin e shtetit ndaj këtyre fenomeneve. Ata nuk dinë për programet e risocializimit dhe riintegrit të personave të dënuar për veprimtari terroriste, cilat janë institucionet përgjegjëse, cili është roli i tyre dhe pse është i rëndësishëm për shoqërinë. Për më tepër, të rinjtë nuk e njohin dhe nuk dinë si të mbrohen nga ky kërcënim potencial, veçanërisht në hapësirën digjitale.
5. Dhuna ndaj të rinjve është e pranishme në një masë të madhe në nivele të ndryshme. Ka dëshmi të forta që tregojnë se të rinjtë përjetojnë ose janë dëshmitarë të dhunës ndaj të

rinjve në ambiente publike, shkolla dhe hapësira digjitale. Veçanërisht janë shqetësuese të dhënat për dhunën në shkollat fillore dhe të mesme, ku dhuna verbale dhe fizike identifikohen si më të zakonshmet. Fakti që vajzat e reja përjetojnë ose janë dëshmitare të dhunës më shpesh se djemtë e rinj duhet të merret parasysh në përdorimin e një qasjeje institucionale të ndjeshme për gjininë dhe në krijimin e mekanizmave për parandalimin, mbrojtjen dhe raportimin e dhunës ndaj të rinjve. Përveç kësaj, të rinjtë përjetojnë edhe bullizëm kibernetik në rrjetet sociale, aplikacione dhe platforma digjitale të ndryshme. Autoritetet në nivelet qendrore dhe lokale nuk bëjnë përpjekje sistematike dhe të mjaftueshme për të luftuar dhunën ndaj të rinjve, veçanërisht në nxitjen e të rinjve, prindërve dhe përfaqësuesve të shkollës për të raportuar dhunën te institucionet përgjegjëse. Ka mungesë të të dhënave të strukturuar dhe të sakta për dhunën ndaj të rinjve në nivel shtetëror që do të ishin më të lehta për t'u arritur nga palët e prekura.

6. Perceptimi i të rinjve për sigurinë e tyre në hapësirën digjitale është i ndarë. Kjo çon në përfundimin se të rinjtë kanë nevojë për arsim dhe informacione praktike të shtuara për rreziqet digjitale, si dhe për njohjen, parandalimin dhe raportimin e bullizmit kibernetik. Si rrjedhojë, të rinjtë nuk janë shumë të shqetësuar për mbrojtjen e të dhënave të tyre në hapësirën digjitale. Abuzimi me të dhënat, fotografitë personale dhe përmbajtjet në internet nuk ndodhin shpesh te të rinjtë. Por, në vitet e fundit, ka pasur raste abuzimi me përmbajtje në internet që kanë çuar në vërejtjen e një krimi të ri - shantazhi, që duhet të futet në Kodin Penal. Për më tepër, ngjarjet e fundit në rajon lidhur me dhunën ndaj të rinjve në shkolla, nga bashkëmohatarët dhe mësuesit, përfunduan tragjikisht me fëmijë si viktime. Këto ngjarje kanë rrënjë në komunikimin në hapësirën digjitale, duke aktivizuar alarm të kuq në institucionet për të marrë masa serioze, vëmendje të shtuar për komunikimin në hapësirën digjitale dhe parandalimin e dhunës.
7. Të rinjtë e identifikojnë origjinën etnike si bazën e parë të diskriminimit, pasuar nga përkatësia politike dhe statusi ekonomik. Duhet të theksohet se edhe në studimet e tjera, origjina etnike dhe përkatësia politike janë identifikuar si bazat kryesore për diskriminim gjatë dhjetë viteve të fundit, duke treguar se përpjekjet për të zvogëluar diskriminimin nuk janë të suksesshme dhe duhet të bëhen më shumë, përfshirë edhe përdorimin e qasjeve inovative. Ndaj, ndarja politike që ekziston në të gjitha nivelet e shoqërisë ndikon negativisht në jetën e të rinjve dhe të ardhmen e tyre. Konflikti i kaluar në vend ka shkakuar ndarje në qytete, kultura dhe komunitete, dhe kjo ende është e pranishme në komunitetet e përziera etnike. Të rinjtë nga komunitetet e ndryshme etnike, përveç maqedonasve dhe shqiptarëve, përjetojnë shpesh diskriminim bazuar në origjinën etnike. Raportimi i diskriminimit nuk është i zakonshëm për të rinjtë në vend, duke treguar mungesën e informacionit për institucionet përgjegjëse për luftën kundër diskriminimit, si dhe mungesën e besimit në procedurat për mbrojtjen nga diskriminimi.
8. Pjesëmarrja e të rinjve në komunitete është në një nivel shumë të ulët, i cili karakterizohet nga një ndjenjë e përgjithshme e zhgënjimit dhe apatisë. Të rinjtë vlerësojnë se nuk janë të informuar për proceset e vendimmarrjes në komunitetet e tyre, nuk janë të përfshirë në vendimmarrje dhe nuk besojnë se kanë ndonjë influencë mbi vendimet e marra në komunitetet e tyre. Ata

konsiderojnë mjedisin e shkollës dhe të punës si pak më demokratik për sa i përket dhënies së informacionit për proceset e vendimmarrjes dhe pjesëmarrjes në këto procese, ndërkohë që mundësia për të ndikuar në vendime është po aq e ulët sa në ndikimin në vendimmarrje në komunitetet e tyre në përgjithësi. Trendi i tjetërsimit tek të rinjtë është i dukshëm. Shumica e të rinjve ndihen të përjashtuar nga vendimet e marra brenda rrjetit të tyre social/grupit të miqve dhe madje shumica prej tyre nuk besojnë në ndikim në ato vendime.

9. Të rinjtë në përgjithësi kanë një ndjesi ambivalente në lidhje me besimin tek të tjerët ose vlerësojnë se nuk mund të besojnë në njerëzit në përgjithësi. Në mënyrë inkurajuese, shumica e të rinjve kanë dikë për t'u drejtuar në situata problematike, për të gjetur ndihmë në momente të vështira ose dikë me të cilin mund të bisedojnë dhe të ndjehen rehat. Qëndrimet për marrëdhëniet ndëretnike duken të jenë të përgjithshme dhe madje më të këqija se në dekadën e kaluar. Shumica e të rinjve nuk kanë besim në njerëzit nga etnitë e tjera, nuk ndjehen të mbështetur nga njerëzit nga etnitë e tjera dhe nuk mund të përfshihen rregullisht në komunikim me njerëz nga kultura dhe etnitë të ndryshme.
10. Autoritetet publike vlerësohen si "pak të besueshme" nga të rinjtë. Besimi më i ulët është ndaj Qeverisë dhe udhëheqësve të partive politike, pasuar nga gjykatat dhe Kuvendi. Ndërsa besimi më i lartë është ndaj policisë, udhëheqësve fetarë dhe organizatave civile.

1.4 REKOMANDIMET PARAPRAKE

1. Vendimmarrësit duhet t'i përfshijnë të rinjtë në zhvillimin e politikave të bazuara në prova në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen. Është jashtëzakonisht e rëndësishme që të rinjtë të përfshihen në identifikimin e rreziqeve të sigurisë në nivel lokal dhe kombëtar dhe në hartimin e zgjidhjeve të përshtatura me nevojat dhe specifikat e rajoneve dhe komuniteteve lokale.
2. Institucionet përgjegjëse për çështjet e sigurisë dhe mbrojtjes së të rinjve duhet të kenë një qasje proaktive, në vend që të reagojnë ndaj rasteve të dhunës dhe kërcënimeve për sigurinë. Është e nevojshme një metodologji ndërinstitutionale specifike për identifikimin, ndjekjen dhe raportimin e dhunës ndaj të rinjve. Është gjithashtu e rëndësishme që institucionet përgjegjëse të vendosin mekanizma për reagim të shpejtë për rastet e dhunës ndaj të rinjve në shkolla.
3. Institucionet shtetërore përgjegjëse për arsimin, sigurinë dhe mbrojtjen e të rinjve si Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Ministria e Punëve të Brendshme dhe Ministria e Politikës Sociale, Demografisë dhe Rinisë, si dhe organizatat jo-qeveritare që punojnë në fushën e rinisë dhe bashkëpunimit me të rinjtë, duhet të vendosin dhe të zbatojnë programe arsimore formale dhe joformale sistimore për të sjellë konceptet e ndërimit të paqes, sigurisë dhe mbrojtjes të të rinjtë. Programet duhet të përshtaten me grupmoshat e të rinjve. Në këto programe duhet të përfshihen të gjitha shkollat në vend.
4. Duhet të zbatohet Ligji për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikën Rinore, me të cilin rregullohet përfshirja dhe angazhimi i të rinjve në proceset vendimmarrëse nacionale dhe

lokale. Autoritetet lokale duhet të japin një rol të rëndësishëm në formimin e Këshillave rinore lokale dhe të ndajnë mjete financiare për funksionimin e tyre të rregullt. Në ato komuna ku nuk ka këshilla rinore lokale, ato duhet të formohen sipas dispozitave ligjore të Ligjit për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikën Rinore. Përveç kësaj, Strategjitë lokale për të rinj duhet të jenë në përputhje me Strategjinë nacionale për të rinj dhe të sigurojnë një fokus të veçantë në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.

5. Përpjekjet institucionale për rritjen e sigurisë dhe mbrojtjes së të rinjve, besimi i tyre në institucione dhe zvogëlimi i diskriminimit duhet të kenë një qasje rajonale. Për këtë qëllim, është e rëndësishme të thellohen në kërkime të kësaj natyre dhe të kryhen hulumtime cilësore rajonale dhe analiza që do të çojnë në përshtatjen e veprimtarive lokale me nevojat e të rinjve në fushën e sigurisë dhe mbrojtjes.
6. Komunave u rekomandohet formimi i Këshillave Lokale për Parandalim. Këshillat gjithashtu mund të marrin në konsideratë përfshirjen e përfaqësuesve nga këshillat rinore lokale dhe të rinjve në përbërjen e tyre, duke rritur kështu besimin e të rinjve në autoritetet lokale. Ato komuna që tashmë kanë këshilla duhet të bëjnë përpjekje dhe të ndajnë buxhete adekuate për funksionimin e këtyre organeve. Gjithashtu, mundësia e rregullimit ligjor të këtyre organeve mund të hulumtohet më tej për të inkurajuar pozicionin e këtyre organeve në nivel lokal.
7. Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të inkurajojë dhe mbikëqyrë zbatimin e Udhëzuesit për procedurën e raportimit dhe mbrojtjes së nxënësve viktime të dhunës në shkollat fillore dhe duhet të gjejë mekanizma për të inkurajuar nxënësit, mësuesit dhe stafin profesional në shkolla për të raportuar dhunën. Qeveria dhe Kuvendi duhet të përshejtojnë procedurën për miratimin e Ligjit për arsimin e mesëm dhe të përfshijnë nënë për mbrojtjen, parandalimin dhe raportimin e dhunës. Udhëzimet për procedurën e raportimit dhe mbrojtjes së nxënësve viktime të dhunës në shkollat e mesme duhet të përgatiten, miratohen dhe zbatohen sa më parë.
8. Programet për trajnime të mësuesve për parandalimin, mbrojtjen dhe raportimin e dhunës në shkolla duhet të realizohen në mënyrë të vazhdueshme dhe të përfshijnë të gjithë mësuesit në vend. Gjithashtu, duhet të hartohen programe të ngjashme për nxënësit e shkollave fillore dhe të mesme për arsim sistematik formal dhe joformal. Po ashtu, autoritetet duhet të hetojnë dhe të transferojnë modele dhe praktika të suksesshme të zbatuara në vende të tjera për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna në shkolla.
9. Qeveria dhe institucionet shtetërore që marrin pjesë në Komisionin Kombëtar për Kundërvënien ndaj Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Kundërvënien ndaj Terrorizmit duhet të ndajnë fonde të mjaftueshme për zbatimin e aktiviteteve që lidhen me të rinjtë në kuadrin strategjik për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm dhe luftën kundër terrorizmit. Përveç kësaj, organizatat e shoqërisë civile dhe organizatat ndërkombëtare duhet të bashkëpunojnë me institucionet shtetërore dhe autoritetet lokale për të zhvilluar dhe ofruar informacion praktik për të rinjtë në lidhje me sistemet lokale dhe kombëtare për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit.

10. Të rinjtë duhet të marrin një edukim të vazhdueshëm për shkollimin digjital të përshtatur me moshën e tyre. Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale dhe Ministria e Shoqërisë Informatike dhe Administratës duhet të planifikojnë dhe të implementojnë aktivitete të tilla në programet e tyre vjetore në bashkëpunim me Ministrinë e Punëve të Brendshme. Përveç kësaj, të rinjtë duhet të marrin një edukim të vazhdueshëm për raportimin e dhunës kibernetike dhe keqpërdorimin e të dhënave. Ata duhet të njihen me rolin e institucioneve përgjegjëse si shkollat, administrata lokale, policia dhe Avokatin e Popullit dhe me procedurën për raportimin e dhunës në internet. Prindërit duhet të përqendrohen gjithashtu në ekspozimin e fëmijëve të tyre në hapësirën digjitale dhe të edukohen përmes fushatave kombëtare për rreziqet në hapësirën digjitale, mekanizmat e arritshëm dhe institucionet përgjegjëse për raportimin e dhunës në internet.
11. Qeveria duhet të ndajë fonde të mjaftueshme financiare për zbatimin e Ligjit për Parandalimin dhe mbrojtjen nga diskriminimi dhe për Komisionin për Parandalimin dhe Mbrojtjen nga Diskriminimi, duke i siguruar logjistikën dhe mbështetjen e nevojshme për të plotësuar plotësisht rolin e tyre. Të dhënat për rastet e diskriminimit të të rinjve duhet të klasifikohen, analizohen dhe publikohen në mënyrë adekuate.
12. Ndarjet etnike në shkolla dhe institucione duhet të reduktohen, të trajtohen sistematikisht dhe përfundimisht të eliminohen. Masat në këtë drejtim duhet të marginalizojnë ndikimin negativ të faktorit politik dhe të forcojnë logjikën e individëve dhe integritetin e tyre si imperativ në marrëdhëniet ndërpersonale dhe profesionale. Në këtë kuptim, partitë politike, forumet rinore të partive politike dhe shoqëria civile duhet të bashkëpunojnë në zbatimin e integritit multi-etnik dhe duhet të shkojnë përtej demonstrimit të vullnetit për të ndërmarrë aktivitete specifike. Për më tepër, Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të inkurajojë integrimin ndëretnik në shkolla dhe të krijojë kushte cilësore për komunikim të rregullt, mbështetje dhe ndërveprim ndërmjet nxënësve të të gjitha nacionaliteteve.
13. Duhet të zgjerohen dhe të kujdesen për kapacitetet dhe programet e Avokatit të Popullit për mbrojtjen e të drejtave të fëmijëve dhe të rinjve. Avokati i Popullit si një institucion nacional i pavarur dhe Zyrat Rajonale të Avokatit të Popullit duhet të kenë kapacitetet dhe burime financiare dhe njerëzore të duhura për të reaguar në kohë dhe për të identifikuar dhe raportuar rastet e dhunës në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e të rinjve, veçanërisht dhunës ndaj të rinjve në shkolla.
14. Trupi Koordinues Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Shpërfillja duhet të sigurojë që të dhënat për dhunën ndaj të rinjve në vend të jenë të sakta, transparente dhe lehtësisht të arritshme për të gjitha palët e interesuara. Ky trup duhet të promovohet tek të rinjtë, prindërit dhe mësuesit si një pikë qendrore për trajtimin e rasteve të dhunës ndaj të rinjve.
15. Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve duhet të bëjë përpjekje për ta bërë punën e tij më transparente dhe për ta afruar atë me publikun e gjerë, veçanërisht me të rinjtë, prindërit, mësuesit dhe ekspertë të tjerë të kësaj fushe. Raportet vjetore të përgatitura nga Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve dhe të dhënat për kriminalitetin e të miturve në vend duhet të jenë publike dhe lehtësisht të arritshme për publikun e gjerë.



2. METODOLOGJIA DHE FUSHA E HULUMTIMIT

2.1 Qëllimi i Hulumtimit


Ky hulumtim vlerësoi perceptimet e të rinjve për sigurinë dhe mbrojtjen, pjesëmarrjen në proceset formale dhe joformale të paqes, statusin e agjendës së të rinjve dhe sigurisë, si dhe çështjet e luftimit dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në vend. Hulumtimi shqyrtoi gjithashtu dhunën tek të rinjtë, përjashtimin dhe marginalizimin në të gjitha nivelet. Hulumtimi ofron një pasqyrë gjithëpërfshirëse të perceptimeve të të rinjve për çështje të tilla si besimi në autoritetet dhe marrëdhëniet e ndërkomuniteteve në dekadat e fundit.

2.2 Metodologjia e hulumtimit dhe karakteristikat e mostrës


Grupi i synuar për këtë hulumtim ishin të rinjtë nga 15 deri në 29 vjeç nga Republika e Maqedonisë së Veriut. Për qëllimet e këtij hulumtimi, një mostër përfaqësuese u zgjodh duke përdorur një mostër të shtrirë në shumë faza me probabilitet proporcional me madhësinë e vlerësuar të popullsisë. Mostra e të anketuarve ishte përfaqësuese e strukturës së popullsisë së përgjithshme në vend, duke përfshirë përkatësinë etnike, gjininë, grupmoshën, vendbanimin (urban/rural) dhe rajonin statistikor (nivelel NUTS 3). Një mostër përfaqësuese e popullsisë së synuar u arrit duke përdorur një metodologji të marrjes së mostrave të telefonit me kornizë të dyfishtë. Gabimi i marrjes së mostrave ishte 2.74% me një nivel besimi prej 95% për një total prej 1,200 anketave telefonike të përfunduara.

Gjithsej 1,235 të anketuar janë përfshirë në mostër përmes anketës telefonike. Gjithashtu, ekipi hulumtues ka realizuar pesë (5) intervista gjysmë të strukturuar me përfaqësues të organizatave kombëtare të rinisë, përfaqësues të institucioneve si Agjencia për Rini dhe Sport, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, Byroja për Zhvillimin e Arsimit, dhe Ministria e Punëve të Brendshme - Byroja e Sigurisë Publike, Sektori për Veprimtarinë Policore dhe Policia e Uniformuar.


Tetë (8) diskutime në fokus grupe u organizuan në të tetë rajonet statistikore me gjashtë (6) deri në tetë (8) individë në secilin grup. Përzgjedhja e individëve u krye në bashkëpunim me organizatat nacionale ombrellë të të rinjve. Intervistat u zhvilluan në gjuhën maqedonase, ndërsa fokus grupet ishin në gjuhën maqedonase dhe shqipe. Karakteristikat specifike të shembullit paraqiten në grafikonët e mëposhtëm:




Grafiku 1: Gjinia



Grafiku 2: Moshë



Grafiku 3: Rajoni



Grafiku 4: Përkatesia etnike



3. DEFINICIONET / PËRKUFIZIMET

Përkufizimet kryesore më poshtë duhet t'i ndihmojnë lexuesit të kuptojnë më mirë disa nga konceptet dhe termat e përdorur në këtë hulumtim. Shumica e përkufizimeve përcaktohen në korniza legjislative ose shtjellime konceptesh të pranura gjerësisht në literaturën publike dhe përkatese.

3.1 TË RINJTË NË REPUBLIKËN E MAQEDONISË SË VERIUT

Sipas Ligjit për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikën Rinore, të rinj janë të gjithë personat në moshën nga 15 deri në 29 vjeç.

3.2 SIGURIA DHE MBROJTJA

Në kontekstin kombëtar, koncepti i sigurisë publike mbulon dy aspekte: së pari, interesin publik (të përgjithshëm) dhe sigurinë personale (individuale). Siguria publike ka të bëjë me sigurinë e të gjithë njerëzve. Siguria personale ka të bëjë me mbrojtjen e individit nga rreziku, situatat kërcënuese për jetën, identitetin fizik dhe pronën e individit, si dhe sigurinë në realizimin e lirisë themelore dhe të drejtave të njeriut që i takojnë individit.²

Një përkufizim gjithëpërfshirës i sigurisë në kuadrin teorik jepet nga Wolfers, i cili thotë se "siguria në një kuptim objektiv mat mungesën e kërcënimeve ndaj vlerave të pranura, ndërsa në një kuptim subjektiv mungesën e frikës se ato vlera do të sulmohen"³. Siguria objektive dhe subjektive janë të ndërlidhura dhe në shumicën e rasteve rriten ose ulen proporcionalisht. Megjithatë, një rritje e sigurisë objektive nuk do të thotë gjithmonë një rritje e sigurisë subjektive dhe anasjelltas.

Në jetën e përditshme, termi mbrojtje shpesh ndërrohet me termin siguri. Ndërsa mbrojtja i referohet një situatë në të cilën ekziston një sundim efektiv i ligjit, si dhe një kombinim i marrëdhënieve njerëzore përmes të cilave njerëzit mund të kryejnë aktivitetet e tyre rutinë, termi siguri mund të nënkuptojë gjëra të ndryshme. Termi siguri është i pranishëm në të drejtën penale si sinonim i mbrojtjes, ndërsa në situata të tjera mund të nënkuptojë një besim të fortë në diçka.

² Gjurovski, M. "Bazat e sigurisë" – Qasjet konceptuale të sigurisë, Fondacioni Konrad Adenauer, Shkup, 2021.

³ Arnold Wolfers. "Siguria kombëtare si një simbol i paqartë në mosmarrëveshje dhe bashkëpunim: Ese për politikën ndërkombëtare." Johns Hopkins University Press: Baltimore (1962): 149.

3.3 NGACIMI KIBERNETIK – BULLIZMI KIBERNETIK

Ngacimi kibernetik është kur dikush është i keq, i pasjellshëm ose tallet me të tjerët duke dërguar ose postuar mesazhe fyese dhe/ose imazhe në një kompjuter ose telefon celular. Mesazhet ose imazhet fyese mund të jenë përmes postës elektronike, telefonave celularë, mesazheve me tekst, faqeve personale në internet si Facebook dhe hapësirave virtuale për bisedë.

3.4 DISKRIMINIMI

Diskriminim është çdo dallim, përjashtim, kufizim ose preferencë që bazohet në baza diskriminuese, me veprime ose mosveprime, të cilat kanë për qëllim ose rezultat të parandalojnë, kufizojnë, njohin, gëzojnë ose realizojnë të drejtat dhe liritë e një personi ose grupi të caktuar në një bazë të barabartë me të tjerët. Kjo përfshin të gjitha format e diskriminimit, duke përfshirë mohimin e përshtatjes së duhur dhe mohimin e aksesit dhe disponueshmërisë së infrastrukturës, mallrave dhe shërbimeve.

3.5 EKSTREMIZMI I DHUNSHËM DHE RADIKALIZIMI QË SHPIE DREJT TERRORIZMIT⁴

Një proces dinamik me të cilin një individ e pranon dhunën terroriste si mënyrë e mundshme, ndoshta edhe legjitime, e veprimit. Eventualisht, mirëpo jo detyrimisht, kjo mund të çojë në atë që personi të përfaqësojë për terrorizëm, të veprojë në mbështetje të terrorizmit ose të përfshihet në terrorizëm.

3.6 DHUNA

Të gjitha format e dhunës fizike ose psikologjike, lëndimit ose abuzimit, neglizhencës ose trajtimit të pakujdesshëm, ngacimit dhe shfrytëzimit të fëmijëve, duke përfshirë ngacimin seksual, që lidhen me besimin dhe kujdesin e prindërve, kujdestarëve ligjorë ose personave të tjerë që kanë kujdestarinë ligjore të fëmijës. Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna (2020 - 2025) e përkufizon gjithashtu abuzimin dhe neglizhimin e fëmijëve si “çdo formë abuzimi fizik dhe/ose emocional, ngacim seksual, neglizhencë ose trajtim të pakujdesshëm ose lloje të tjera të shfrytëzimit komercial, që mund të shkaktojë një kërcënim ose dëmtim për shëndetin, mbijetesën, zhvillimin ose dinjitetin e fëmijës në kontekstin e përgjegjesisë, besimit dhe pushtetit reciprok.”

⁴ Terminologjia "Ekstremizmi i dhunshëm dhe radikalizimi që shpie drejt terrorizmit" është konsoliduar me Deklaratën Ministrore për Forcimin e Përpjekjeve të OSBE-së për Parandalimin dhe Luftimin e Terrorizmit, miratuar në takimin ministror në dhjetor 2016 (MC.DOC 1/16). Terminologjia e njëjtë është përfshirë në Strategjinë Kombëtare për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (2023 - 2027).



4. ANALIZA KONTEKSTUALE

Analiza kontekstuale siguron informacione relevante të nxjerra nga shqyrtimi i literaturës në lidhje me sigurinë dhe mbrojtjen e fëmijëve dhe të rinjve në një kuptim më të gjerë, si dhe parandalimin e dhunës. Kjo pjesë është ndarë në tri pjesë për të pasqyruar specifikat e temës, duke u elaboruar përmes analizës së legjislacionit, strukturës strategjike dhe programore, dhe mekanizmave institucional për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna.

4.1 ANALIZA E LEGJISLACIONIT

– Korniza ndërkombëtare

Shtetet anëtare të OSBE-së e njohin vazhdimisht kontributin e të rinjve në forcimin e paqes dhe sigurisë. Dokumentet ndërkombëtare të mëposhtme njohin rëndësinë e të rinjve në sigurimin e paqes dhe stabilitetit dhe zgjidhjen e çështjeve të sigurisë së të rinjve.

Deklarata e OSBE-së për të Rinjtë, Këshilli i Ministrave, Vendimi nr. 3/14, Bazel, njeh “potencialin e të rinjve për të kontribuar në zhvillimin ekonomik, politik dhe social” dhe “për të mbështetur shtetet pjesëmarrëse në zbatimin e obligimeve të tyre në të tri dimensionet e OSBE-së”.

Deklarata e OSBE-së për të Rinjtë dhe Sigurinë, Këshilli i Ministrave, Vendimi nr. 5/15, Beograd, afirmon se “të rinjve dhe fëmijëve duhet t’u kushtohet vëmendje e veçantë dhe se nevojat, shqetësimet dhe interesat e tyre duhet të trajtohen në mënyrë gjithëpërfshirëse.”

Deklarata e OSBE-së për rolin e të rinjve në kontributin e përpjekjeve për paqen dhe sigurinë, Këshilli i Ministrave, Vendimi nr. 18/3, Milano, njeh rolin që të rinjtë mund ta kenë në mbështetjen e shteteve pjesëmarrëse në zbatimin e zotimeve të tyre në të tri dimensionet. Ajo njeh rolin që të rinjtë mund ta luajnë në kontributin për kulturën e paqes, dialogut, drejtësisë dhe bashkëjetesës paqësore, besimit dhe pajtimit.

Rezoluta 2250 (2015) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara është rezoluta e parë e Këshillit të Sigurimit që njeh rolin e rëndësishëm që të rinjtë, si vajzat dhe djemtë, kanë në ruajtjen dhe promovimin e paqes dhe sigurisë ndërkombëtare. Ajo fton shtetet anëtare të mendojnë për themelimin e mekanizmave që do t’u lejojnë të rinjve të përfshihen në mënyrë të konsiderueshme në proceset e paqes dhe në zgjidhjen e konflikteve. Rezoluta 2250 (2015) e Kombeve të Bashkuara tërheq vëmendjen për aspektet e mëposhtme të jetës së të rinjve:

- *Pjesëmarrje*: Për të marrë parasysh pjesëmarrjen dhe qëndrimet e të rinjve në proceset e vendimmarrjes, nga negociatat dhe parandalimi i dhunës deri te marrëveshjet paqësore;
- *Mbrojtje*: Për të siguruar mbrojtjen e jetës dhe të drejtave të njeriut të qytetarëve të rinj dhe për të hetuar dhe ndjekur ata që janë përgjegjës për krime të kryera ndaj tyre;
- *Parandalim*: Për të mbështetur të rinjtë në parandalimin e dhunës dhe për të promovuar një kulturë të tolerancës dhe dialogut ndërkulturor;
- *Partneritet*: Për të angazhuar të rinjtë gjatë dhe pas konfliktit në zhvillimin e strategjive për ndërtimin e paqes, së bashku me aktorët nga komuniteti dhe organet e Kombeve të Bashkuara;
- *Rezistencë dhe reintegrime*: Për të investuar në të rinjtë e prekur nga konfliktet e armatosura përmes mundësive për punësim, politikat gjithëpërfshirëse të punësimit dhe arsimit që promovojnë një kulturë të paqes.

Rezoluta 2419 (2018) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara njeh "rolin që të rinjtë mund të kenë në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve dhe fton Sekretarin e Përgjithshëm dhe përfaqësuesit e tij special të marrin parasysh pikëpamjet e tyre në diskutimet për sigurinë dhe të mundësojnë pjesëmarrje të barabartë dhe të plotë në procesin e vendimmarrjes".

Rezoluta 2535 (2020) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara, nënvizoi rolin e të rinjve në parandalimin dhe zgjidhjen e konflikteve, si dhe në ndërtimin dhe ruajtjen e paqes, duke inkurajuar Shtetet Anëtare që të përfshijnë të rinjtë në proceset vendimmarrëse në këto fusha.

– Korniza kombëtare⁵

Përderisa dokumentet strategjike parashikojnë synimin strategjik të Qeverisë për të përmirësuar dhe forcuar rolin e të rinjve në vend, përmes zgjidhjeve praktike, ligjet ofrojnë bazën ligjore. Ligjet dhe politikat përkatëse që lidhen veçanërisht me të rinjtë janë paraqitur më poshtë. Analizohen ligjet që i referohen sigurisë së të rinjve dhe se si ajo rregullohet në dokumentet ligjore.

– Ligji për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikat Rinore (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 10/2020)

Ky Ligj përcakton format e organizimit dhe pjesëmarrjes së të rinjve në nivel kombëtar dhe vendor. Në përputhje me nenin 5, Ligji shpjegon parimet bazë të cilat përfshijnë:

- Barazinë, mundësitë e barabarta dhe ndalimin nga diskriminimi;
- Pavarësinë, pluralizmin dhe demokracinë në të gjitha format e organizimit të të rinjve;
- Transparencën dhe publicitetin;
- Ngritjen e vetëdijes për rëndësinë e të rinjve dhe rolin e tyre shoqëror;

⁵ Rregulloret dhe dokumentet juridike që rregullojnë sigurinë dhe rendin në shtet për të gjithë qytetarët, të cilat nuk përbajnë nene specifike për të rinjtë (si Kodi Penal, Ligji për Policinë, Ligji për Ministrinë e Punëve të Brendshme, Ligji për Agjencinë e Sigurisë Kombëtare etj.), nuk do të shpjegohen në mënyrë të veçantë, pasi ato rregullojnë kuadrin institucional të sektorit të sigurisë dhe institucioneve të veçanta.

- Multikulturalizmin, interkulturalizmin dhe përfshirjen në pjesëmarrjen aktive të të rinjve;
- Përfshirjen dhe ndërlidhshmërinë multietnike të organizimit rinor dhe menaxhimit të politikave rinore publike;
- Përgjegjësinë dhe solidaritetin e të rinjtë; dhe
- Bashkëpunimin ndërinstitucional në krijimin dhe zbatimin e politikave të të rinjve.

Edhe pse Ligji nuk përfshin drejtpërdrejt fushën e sigurisë dhe mbrojtjes, parimet e mosdiskriminimit, multikulturalizmit dhe interkulturalizmit lidhen me komunikimin e hapur, barazinë dhe marrëdhëniet paqësore të të rinjve.

– Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhunës në familje (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 24/2021)

Ky Ligj rregullon veprimtarinë e institucioneve në marrjen e masave parandaluese kundër dhunës bazuar në gjininë ndaj grave dhe dhunës në familje, koordinimin e institucioneve përgjegjëse për parandalimin e dhunës dhe mbrojtjen e viktimave, si dhe mbledhjen e të dhënave për dhunën bazuar në gjininë dhe dhunën në familje. Ligji rregullon shërbimet për gratë viktime të dhunës dhe të drejtën për ndihmë ligjore falas, si dhe mbrojtjen e viktimave në procedurat gjyqësore dhe viktimizimin.

– Ligji për sportin (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 29/2002)

Neni 59 i Ligjit cakton përgjegjësitë e organizatorëve të manifestimeve dhe garave sportive për zbatimin e masave për parandalimin e sjelljeve të dhunshme të publikut. Për më tepër, ky nen përfshin edhe përgjegjësinë e personelit zyrtar që drejtojnë institucionet përgjegjëse për punën në sport. Organizatori i manifestimeve dhe garave sportive duhet të respektojë kufijtë e parapara për kapacitetin e objektit sportiv. Megjithatë, Ligji nuk përmban principe për parandalimin e sjelljeve të dhunshme në eventet sportive dhe, më tej, nuk ka nen që të rregullojë sjelljen e grupeve të tifozëve në eventet sportive. Ligji përfshin masat represive për sjelljet e dhunshme.

– Ligji për familjen (teksti i konsoliduar, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale⁶)

Në pjesën e parë të Ligjit janë përcaktuar parimet e përgjithshme, duke përfshirë të drejtën e fëmijëve për të qenë të mbrojtur nga prindërit dhe detyrimin e prindërve për t'u kujdesur dhe mbrojtur fëmijët e tyre. Në pjesën e tretë, Ligji rregullon marrëdhëniet midis prindërve dhe fëmijëve të tyre dhe lidhur me të drejtat dhe detyrimet e përgjithshme për mbrojtjen dhe kujdesin për fëmijët, realizimin e të drejtave prindërore, mbikëqyrjen nga Qendra për Punë Sociale dhe privimin e mundshëm nga të drejtat prindërore, veçanërisht në rastet e dhunës ndaj fëmijëve. Në pjesën VI-të, Ligji përcakton konceptin e dhunës në familje, situatat e dhunës, viktimat dhe autorët. Gjithashtu, Ligji rregullon procedurën për masat e përkohshme për mbrojtjen nga dhuna në familje, si dhe ndëshkimet dhe sanksionet në këtë drejtim.

⁶ https://www.mtsp.gov.mk/wbstorage/files/zakon_osejstvo_osnoven.pdf

– Ligji për mbrojtjen sociale (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 104/2019)

Në përgjithësi, ky Ligj rregullon të drejtat sociale të qytetarëve dhe ofrimin e shërbimeve sociale nga institucionet shtetërore, shoqëritë civile dhe personat fizikë. Për këtë qëllim, nën kushte të caktuara, të rinjtë mund të realizojnë disa të drejta sociale si anëtarë të familjes ose si të mitur pa prindër. Në nenet 57 dhe 63 të Ligjit, janë paraparë të drejta sociale për strehim dhe ndihmë ekonomike një herë për të miturit pa prindër, ndërsa në nenet e tjera është e paraparë e drejta për mbrojtje shëndetësore dhe sociale dhe shërbime për viktimat e dhunës.

Një strukturë ligjore konkrete është e disponueshme në fushën e mbrojtjes së fëmijëve, përfshirë mbrojtjen nga dhuna ndaj fëmijëve, drejtësinë për fëmijët dhe mbrojtjen nga dhuna në fushën e arsimit. Meqenëse ky hulumtim mbulon një grup të synuar të të rinjve të moshës 15 - 18 vjeç, më poshtë është një pasqyrë e normave kryesore ligjore në këtë fushë.

– Ligji për mbrojtjen e fëmijëve (teksti i konsoliduar, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale)⁷

Ky Ligj rregullon mbrojtjen e fëmijëve dhe llojet e mbrojtjes, si dhe themelimin dhe funksionimin e institucioneve dhe organizatave për mbrojtjen dhe kujdesin e fëmijëve. Në nenin 4, ky Ligj rikujton parimet e veprimit në interesin më të mirë të fëmijës, duke përfshirë çdo formë diskriminimi dhe duke respektuar të drejtën e fëmijës për liri dhe siguri personale.

– Ligji për drejtësinë për fëmijët (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 66/24)

Ligji përcakton terminologjinë lidhur me drejtësinë për fëmijët dhe procedurat në rastet kur fëmijët janë autorë, viktimë ose dëshmitarë të krimeve. Korniza në këtë Ligj parashikon mbrojtjen e fëmijëve në formën e procedurave të negociatës dhe proceseve të ndërmjetësitimit, si dhe mbrojtjen në proceset gjyqësore për fëmijët si autorë, ashtu edhe për fëmijët viktimë dhe dëshmitarë. Për të zvogëluar ndikimin e proceseve dhe masave gjyqësore në zhvillimin e fëmijëve, ekziston një listë masash që lidhen me drejtësinë e fëmijëve në institucione të ndryshme arsimore, qendra për zhvillimin e hershëm të fëmijërisë, masa alternative, qortime etj. Kapitulli 16 parashikon mbrojtjen dhe trajtimin e fëmijëve viktimë të krimeve dhe shkeljeve.

– Ligji për arsimin fillor (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 169/19 dhe 229/20) përfshin udhëzime për procedurën e raportimit dhe mbrojtjen e nxënësve-viktimave të çfarëdo lloj forme të dhunës, abuzimit dhe neglizhencës⁸

Në nenet 65 dhe 66 të Ligjit për arsimin fillor parashikohet parandalimi dhe mbrojtja e nxënësve nga dhuna dhe përfshirja e aktiviteteve për parandalimin e dhunës në programin vjetor të shkollës. Ligji parashikon edhe sanksione për personat dhe institucionet përgjegjëse. Për më tepër, Udhëzimi përcakton lloje të ndryshme të dhunës, neglizhencës dhe abuzimit të nxënësve në kontekstin

⁷ Në dispozicion në: <https://dspdp.com.mk/wp-content/uploads/2024/05/Zakon-za-pravda-za-decata.pdf>

⁸ Udhëzime për procedurën e denoncimit dhe mbrojtjes së nxënësit viktimë e dhunës, Ministria e Arsimit dhe Shkencës, nr. 18-6570/1, më datë 06.07.2020.

shkollor dhe parashikon veprimet që duhet të ndërmarrin shkolla, drejtori dhe personeli i shkollës në rastet e dhunës ndaj nxënësve. Shkollat janë të detyruara të ofrojnë mbështetje për viktimat e dhunës, por edhe të punojnë me autorët.

– Ligji për arsimin e mesëm⁹ (teksti i konsoliduar, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale)

Ky Ligj aktualisht është në proces të revizionit. Megjithatë, në versionin aktual të Ligjit, neni 51 ndalon dhunën fizike dhe psikike ndaj nxënësve dhe parashikon masa për këshillim të fëmijëve dhe prindërve në rastet e sjelljes së dhunshme. Sipas një interviste të bërë me zyrtarët e nivelit kombëtar, projektligji për arsimin e mesëm është në procedurë dhe do të përmbajë nene të ngjashme për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna si në Ligjin për arsimin fillor.

4.2 KORNIZA STRATEGJIKE DHE PROGRAMORE

Korniza strategjike dhe programore për të rinjtë përfshin qëllime dhe masa specifike për sigurinë dhe për mbrojtjen e të rinjve, parandalimin e dhunës, mbrojtjen nga dhuna, si dhe mekanizma të ndryshëm për raportimin e sjelljes së dhunshme dhe shkeljen e të drejtave të të rinjve.

– Strategjia nacionale për të rinj për periudhën (2023 - 2027) me Planin nacional të veprimit për periudhën (2023 - 2025) (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 204/23)

Për herë të parë, Strategjia nacionale për të rinj përfshin sigurinë (dhunën) si një nga tetë temat që trajtohen në Strategji. Tema siguria (dhuna) përfshin katër qëllime strategjike që mbulojnë fushat e sigurisë fizike dhe integritetit në hapësirat publike, garantimin e lirisë së shprehjes, luftën kundër polarizimit, diskriminimit dhe ekstremizmit, besimin e të rinjve në institucione dhe institucione të sensibilizuara për punën me të rinjtë dhe ndërgjegjësimin për zbatimin e masave për zvogëlimin e dhunës ndërmjet bashkëmoshatarëve, sigurinë dhe "higjienën" digjitale brenda institucioneve arsimore.

– Strategjia Kombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut për Luftë kundër Terrorizmit (2023 - 2027) dhe Strategjia Kombëtare e Republikës së Maqedonisë së Veriut për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (2023 - 2027)¹⁰

Strategjitë janë përgatitur nga Komiteti Kombëtar për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Luftën kundër Terrorizmit. Dy strategjitë kombëtare janë miratuar nga Qeveria dhe paraqesin vazhdimësi të strategjive nga periudha e mëparshme, si dhe një përpjekje kolektive e Komitetit Kombëtar për të arritur një kuptim të përbashkët për qëllimet, vizionin dhe misionin kombëtar.

⁹ Në dispozicion në: <https://mon.gov.mk/stored/document/Zakon%20za%20srednoto%20obrazovanie.pdf>

¹⁰ Në dispozicion në: https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/nacionalna_strategjia_sne_2023-2027.pdf dhe https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/nacionalna_strategjia_bpt_2023-2027.pdf.

Këto strategji identifikojnë katër (4) prioritetet të përbashkëta strategjike: parandalimin, mbrojtjen, përforcimin dhe reagimin. Sipas strategjive, misioni i përgjithshëm i parandalimit të përhapjes së ideologjisë radikale dhe luftimit të dhunës politike është zhvillimi i kapaciteteve dhe aktivitetëve efektive, të përgjegjshme dhe gjithëpërfshirëse qeveritare dhe shoqërore për të parandaluar, mbrojtur, ndjekur penalisht dhe për t'iu përgjigjur radikalizimit dhe përhapjes së ideologjisë radikale që mund të çojë në dhunë politike, në përputhje me vlerat e shtetit, për të mundësuar/promovuar një shtet të sigurt dhe të prosperuar.

Aktivitetet për të rinjtë janë të integruara në mënyrë të veçantë në Strategjinë për parandalimin e ekstremizmit të dhunshëm. Aktivitetet me të rinjtë në këtë drejtim janë të orientuara drejt parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit, duke përfshirë lëndë mësimore të ndryshme, fushata dhe aktivitete në shkolla për parandalimin e përhapjes së këtyre fenomeneve. Është e rëndësishme të theksohet se të dyja strategjitë identifikojnë qëllimet dhe masat për luftën kundër terrorizmit, radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm në internet. Në zhvillimin e strategjive të reja janë përfshirë shumë aktorë, institucione shtetërore, sektori civil, komunitetet fetare dhe gazetarët. Disa punëtori janë zbatuar me mbështetjen e Misionit të OSBE-së në Shkup, dhe rezultatet e tyre janë përdorur si bazë për strategjitë.

– Strategjia Kombëtare (2020 - 2025) dhe Plani i Veprimit (2020 - 2022) për parandalimin dhe mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna¹¹

Strategjia ofron një pasqyrë të gjerë të gjendjes së dhunës në vend dhe paraqet sistemin kombëtar për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna, duke përfshirë strukturën ligjore në dispozicion në këtë fushë dhe organizmat, mekanizmat dhe institucionet e krijuara. Kjo strategji përcakton konceptin e dhunës ndaj fëmijëve si "të gjitha format e dhunës fizike ose psikike, dëmtimet ose abuzimi, neglizhenca ose marrëdhënia e papërgjegjshme, shqetësimi dhe shfrytëzimi i fëmijëve, duke përfshirë dhe shqetësimin seksual në lidhje me besimin dhe kujdesin e prindërve, kujdestarit ligjor ose person tjetër që ka përkujdesje ligjore për fëmijën. Strategjia, gjithashtu, përcakton termin e abuzimit dhe neglizhencës së fëmijëve si "çdo formë e abuzimit fizik dhe/ose emocional, shqetësim seksual, neglizhencë ose veprim pa ndërgjegjësi ose eksploatim komercial ose lloj tjetër i eksploatimit, që potencialisht mund të sjellë kërcënime ose dëme për shëndetin e fëmijës, jetesën e tyre, zhvillimin ose dinjitetin në kontekstin e marrëdhënies së ndërsjellë të përgjegjësive, besimit dhe pushtetit". Gjithashtu, Strategjia përcakton format e ndryshme të abuzimit ose neglizhencës, si dhe dhunën nga bashkëmohatarët - bullizmin, dhuna familjare dhe dhuna në marrëdhëniet me adoleshentët.

Strategjia përfshin gjashtë fusha strategjike: kornizën kombëtare strategjike dhe ligjore për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna; promovimi i njohurive, praktikave dhe vlerave mbështetëse për të promovuar tolerancën zero ndaj dhunës; programe parandaluese për parandalimin e dhunës në familje dhe rritjen e qëndrueshmërisë së familjeve; kapacitetet e institucioneve të përgjegjësisë ndërsektoriale për mbrojtjen, trajtimin dhe mbështetjen e fëmijëve; mbrojtjen dhe mbështetjen e fëmijëve në sistemin e drejtësisë dhe një sistem për të vërtetuar dhe monitoruar situatën me autorët e dhunës. Në kuadër të Planit të Veprimit përfshihen masa të ndryshme në secilën prej fushave strategjike. Megjithatë, nuk kishte raporte të disponueshme për publikun për zbatimin e

¹¹ Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve, Strategjia Kombëtare (2020 - 2025) dhe Plani i Veprimit për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna (2020 - 2022) në dispozicion në: <https://www.wmtsp.gov.mk/dokumenti.nsp>.

Strategjisë dhe Planit të Veprimit për të vlerësuar nivelin e zbatimit dhe rezultatet e arritura deri më tani.

– Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Drejtësinë për Fëmijët në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2022 - 2027) dhe Plani i Veprimit (2022 - 2023)¹²

Këto dokumente përgatiten nga Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve. Strategjia përfshin 12 fusha strategjike që i referohen aspekteve të ndryshme të përmirësimit të situatës së fëmijëve që janë në konflikt me ligjin si dhe parandalimit të delikuencës së të miturve. Strategjia rregullon programet e këshillimit për nxënësit dhe prindërit që zbatohen në shkollat fillore dhe të mesme për parandalimin ose trajtimin e delikuencës dhe dhunës tek të miturit në shkolla. Sipas të dhënave më të fundit të strategjisë, në vitin 2021 në shkollat fillore janë kryer 8,324 konsultime me nxënësit, kryesisht për klasat e shkollës, frekuentimin e parregullt të shkollës apo sjelljen e papërshtatshme. Gjithashtu, janë realizuar 8,660 konsulta me prindër. Për më tepër, zona strategjike 11 përfshin aktivitete për të rritur ndërgjegjësimin për të drejtat e fëmijëve.

4.3 MEKANIZMAT INSTITUCIONALE PËR PARANDALIM DHE MBROJTJEN NGA DHUNA

Mekanizmat kyç institucional për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna dhe për drejtësi për fëmijët janë Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve dhe Trupi Koordinues Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Neglizhimi. Krijimi dhe roli i këtyre mekanizmave është shpjeguar shkurtimisht në paragrafët e mëposhtëm.

– Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve

Ligji për Drejtësi për Fëmijët në Kapitullin 17 rregullon formimin dhe punën e Këshillit Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve. Këshilli është themeluar në vitin 2009 dhe përfshin 15 anëtarë me mandat pesëvjeçar të cilët zgjidhen nga institucionet përgjegjëse, si dhe ekspertë të zgjedhur me shpallje publike. Këshilli përgatit dhe miraton Strategjinë për delikuencën e të miturve dhe raportin për punën e tij përmes raporteve vjetore të paraqitura në Kuvend. Format i raportimit është krijuar, duke u bazuar në një grup indikatorësh. Programet vjetore të Këshillit përfshijnë aktivitete të përgjithshme pa specifikuar temat, iniciativat dhe bashkëpunimin specifik që Këshilli planifikon të krijojë. Sipas raportit të vitit 2020, gjykatat identifikojnë dhe raportojnë numrin më të madh të fëmijëve viktime, në krahasim me institucionet e tjera, ndërsa numri i fëmijëve viktime të raportuara nga Qendrat e Punës Sociale është shumë i vogël. Roli i këtij Këshilli është të bëjë rekomandime për reduktimin e delikuencës tek të miturit dhe të motivojë zyrtarët përgjegjës që të punojnë në parandalimin e delikuencës tek të miturit.

¹² Këshilli Shtetëror për Parandalimin e Delikuencës së të Miturve, Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Drejtësinë për Fëmijët në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2022 - 2027) dhe Plani i Veprimit (2022 - 2023) në dispozicion në: <http://dspdp.com.mk/vesti/promocija-na-nacionalnata-strategjia-za-prevencija-i-pravda-za-decata-2022-2027/>.

Në raportin për vitin 2020, Këshilli rikujtoi se komunat nuk e zbatojnë detyrimin për themelimin e Këshillave lokale për parandalimin e delikucencës së të miturve. Këto këshilla vendorë janë formuar në numër shumë të vogël dhe shumica e tyre nuk funksionojnë për shkak të mungesës së fondeve.

– Trupi Koordinues Kombëtar për Mbrojtjen e Fëmijëve nga Abuzimi dhe Neglizhimi

Ky organ u krijua me Vendimin e Qeverisë nr. 44-7278/1, me datë 12.12.2017¹³, për monitorimin dhe bashkërendimin e zbatimit të aktiviteteve për mbrojtjen e fëmijëve nga abuzimi dhe neglizhenca dhe përgatitjen e raporteve vjetore. Ky organ ka përgatitur raportin e parë në vitin 2017 për situatën në lidhje me mbrojtjen e fëmijëve nga dhuna sipas treguesve të përcaktuar të monitorimit. Ky organ duhet të përgatisë një raport vjetor çdo vit, por këto raporte, edhe pse duhet të jenë të disponueshme për publikun, nuk janë lehtësisht të aksesueshme.

¹³ Vendim i Qeverisë nr. 44-7278/1, me datë 12.12.2017.



5. REZULTATET E HULUMTIMIT NË TERREN

Ky seksion përfshin një analizë të rezultateve të mbledhura nëpërmjet një sondazhi dhe fokus grupeve me të rinjtë e moshës 15 deri në 29 vjeç. Seksioni ofron një përmbledhje të rezultateve sipas fushave individuale, duke përfshirë:

1. Perceptimi i sigurisë dhe mbrojtjes;
2. Pjesëmarrja në proceset formale dhe joformale të paqes;
3. Kundërvënia ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit;
4. Dhuna tek të rinjtë;
5. Ngacmimi kibernetik – Bullizmi kibernetik;
6. Përgjithësimi dhe diskriminimi; dhe
7. Besimi në autoritetet dhe të tjerët, si dhe marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve.


Secili seksion përfundon me konkluzione dhe rekomandime specifike.

5.1 PERCEPTIMI I SIGURISË DHE MBROJTJES

Perceptimi i të rinjve për sigurinë dhe mbrojtjen fillon me një studim të mendimit të tyre për problemet kryesore, analizimin e perceptimit të niveleve aktuale të sigurisë dhe mbrojtjes në vend, si dhe perceptimin e sigurisë për të ardhmen në pesë vitet e ardhshme. Gjithashtu, ky seksion shqyrton se sa të sigurt e ndjejnë të rinjtë vendbanimin e tyre, vendin e tyre dhe ambientet publike. Në fund, ky seksion hulumton shqetësimet për fenomene të ndryshme që ndikojnë në sigurinë.

– Nivelet e mbrojtjes dhe sigurisë në vend


Nga të rinjtë u kërkua të vlerësonin mbrojtjen dhe sigurinë në vend në një shkallë ku 1 nuk është aspak i sigurt, ndërsa 5 është plotësisht i sigurt. Vlerësimi mesatar për sigurinë dhe mbrojtjen është 3.4, që do të thotë as të sigurt, as të pasigurt. Megjithatë, shumica e të anketuarve (54%) e shohin vendin si një vend ku është relativisht ose krejtësisht i sigurt (vlerësime 4 dhe 5 në shkallën e vlerësimit), ndërkohë që 17% e të rinjve besojnë se vendi nuk është një vend i sigurt. Rezultatet sipas gjinisë dhe grupmoshave janë në përputhje me rezultatet për të gjithë grupin e shqyrtuar.



Grafiku 5: Niveli aktual i sigurisë

Analiza sipas rajoneve gjeografike tregon se një pjesë më e madhe e të rinjve nga rajoni Juglindor (78%) e konsiderojnë vendin si i sigurt dhe i qetë në krahasim me rajonet e tjera. Në të njëjtën kohë, një pjesë më e madhe e të rinjve nga rajoni Verilindor (32%) e shohin vendin si jo të sigurt dhe të qetë në krahasim me rajonet e tjera. 32% e romëve dhe 21% e shqiptarëve mendojnë se vendi nuk është i sigurt, krahasuar me 16% e maqedonasve.

Për sa i përket pritjeve për sigurinë, të anketuarit janë pyetur se çfarë do të ndodhë me nivelin e sigurisë në vend në pesë vitet e ardhshme. Shumica e të rinjve (56%) besojnë se situata do të mbetet e njëjtë, ndërsa mbi një e katërta (27%) besojnë se situata do të përkeqësohet.




Grafiku 6: Pritjet e nivelit të sigurisë

Duke analizuar rezultatet sipas rajoneve, është interesante të theksohet se shumica e të rinjve (52%) nga rajoni Verilindor besojnë se situata do të jetë më e keqe. Më optimistë se situata do të përmirësohet janë të rinjtë e rajonit Jugperëndimor në krahasim me rajonet e tjera. Gjithashtu, një përqindje pak më e lartë e atyre që jetojnë në zonat rurale (20%) krahasuar me ata që jetojnë në qytet (15%) besojnë se situata do të përmirësohet. Po ashtu, pothuajse 1/3 e shqiptarëve janë

optimistë se situata do të përmirësohet, ndërsa 1/3 e maqedonasve dhe romëve dhe gjysma e serbëve në anketë besojnë se situata do të përkeqësohet.

- Siguria dhe mbrojtja në vendbanime dhe vendet publike

Të rinjve iu kërkua të zgjidhnin se sa të sigurt ndiheshin në vende të ndryshme. Në përgjithësi, rezultati tregon se të rinjtë ndjehen më pak të sigurt në vende më të mëdha dhe në ambientet virtuale (si hapësira digjitale). Kështu, 17% të të rinjve ndjehen të pasigurt në hapësirën digjitale, ndërsa 11% ndjehen të pasigurt në vendin (shtetin) e tyre. 81% e të rinjve ndjehen të sigurt në lagjen e tyre dhe 70% në qytetin e tyre.



Grafiku 7: Ndjenja e sigurisë në vende publike

Në përgjithësi, të rinjtë meshkuj dhe femra ndjehen të sigurt në pothuajse të gjitha vendet (përveç hapësirës digjitale), megjithëse përqindja e femrave të reja që ndjehen të sigurta është më e ulët se ajo e meshkujve të rinj. Përveç kësaj, përqindja e femrave të reja që nuk ndjehen as të sigurta as të pasigurta është më e lartë sesa ajo e meshkujve të rinj.

"Si një femër, nuk ndjehem e sigurt kur shkoj vetëm në rrugë në mbrëmje. Kam ndjenjën se dikush mund të më sulmojë. Kjo ndodh shpesh edhe pse personalisht nuk kam përjetuar një situatë të tillë."

Femër, 16 vjeçare (Strugë)

Pjesa më e madhe e të rinjve sipas grupmoshave ndihen të sigurt në vendet e përmendura, me përjashtim të hapësirës digjitale, ku pothuajse pjesë të barabarta të të rinjve ndihen të sigurt dhe as të sigurt e as të pasigurt. Megjithatë, përqindja e të rinjve të grupmoshës 19 - 24 vjeç që ndihen të sigurt është disi më e ulët se dy grupmoshat tjera.

Në të gjitha rajonet gjeografike, shumica e të rinjve ndjehen të sigurt në fshatrat dhe qytetet e tyre. Më të sigurt ndjehen të rinjtë në rajonin e Vardarit. Megjithatë:


- Për sa i përket sigurisë në lagjet e tyre, një pjesë më e madhe e të rinjve në rajonin e Shkupit (25%) dhe në rajonin e Pollogut (23%) nuk ndjehen as të sigurt as të pasigurt në krahasim me rajonet e tjera (nga 3% deri në 11%).
- Për sa i përket sigurisë në zonë/qytet, shumica e të rinjve në rajonin Verilindor, gjegjësisht në qytetet e Kriva Pallankës dhe Kumanovës (15%) ndihen të pasigurt në krahasim me rajonet tjera (nga 2% në 9%).
- Për sa i përket sigurisë në vend, një përqindje më e madhe e të rinjve në rajonin Verilindor (32%) ndihen të pasigurt krahasuar me rajonet e tjera (nga 4% në 12%).

Pjesëmarrësit në fokus grupet nga rajoni i Pollogut dhe Verilindor tregojnë shqetësime të ndryshme në lidhje me sigurinë, si siguria në rrugë, siguria në shkollë, dhe siguria digjitale, ndërsa ata nga rajoni i Vardarit dhe Pellagonisë ndjehen relativisht të sigurt, duke theksuar: "Në përgjithësi, ne jemi një vend i qetë"; "Po, ndjehem mjaft i sigurt".

Shqiptarët, si dhe romët, në një përqindje pak më të madhe nuk ndihen të sigurt apo të pasigurt në krahasim me maqedonasit dhe grupet e tjera etnike.

Për sa i përket hapësirës digjitale, të rinjtë nga rajonet Jugperëndimore (31%) dhe Verilindore (23%) ndjehen dukshëm të pasigurt në krahasim me rajonet e tjera (duke filluar nga 8% në 19%). Gjithashtu, një përqindje më e madhe e romëve (23%) dhe shqiptarëve (20%) ndihen të pasigurt në hapësirën digjitale në krahasim me maqedonasit (15%).

Sa i përket ndjenjës së sigurisë në vende publike, shumica e të rinjve ndjehen pothuajse njëllor të sigurt në transportin publik (53%) dhe në parqe publike, shtigje për ecje dhe korsi për biçikleta (54%). Megjithatë, përqindja e atyre që ndihen të pasigurt është pak më e lartë në transportin publik (11%) sesa në parqet publike, shtigjet e ecjes dhe korsitë për biçikleta (9%).



Ndërsa shumica e të anketuarve meshkuj (57%) ndihen të sigurt në transportin publik, përqindja e të anketuarve femra që ndihen të sigurt është më e ulët (48%). Madje të anketuarat femra që ndihen krejtësisht të pasigurt përbëjnë 11% kundrejt 9% të të anketuarve meshkuj. Përkatësisht, përqindja e të anketuarve femra që ndihen më të sigurt është më e ulët se ajo e të anketuarve meshkuj.

"Transporti publik është shumë i rëndësishëm për mua. E përdor shpesh transportin publik. Nuk ndihem fare e sigurt, sepse ka situata kur dikush nxjerr thikë, fillojnë grinden, autobusi digjet. Thjesht nuk ndihem shumë e sigurt kur jam në transport publik, por nuk kam tjetër zgjedhje."

Femër, 19 vjeçare (Shkup)

Sipas grupmoshave, pjesa më e madhe e të rinjve të moshës 15 - 18 dhe 25 - 29 vjeç ndihen të sigurt në transportin publik, ndërsa ata të moshës 19 - 24 ndihen të sigurt (47%) dhe as të sigurt dhe as të pasigurt (41%). Për sa i përket sigurisë së shesheve, shtigjeve për ecje dhe korsive për biçikleta, shumica e të tre grupmoshave ndihen të sigurt.

Në aspekt rajonal, në Shkup, në rajonin Verilindor dhe Lindor, të rinjtë në përgjithësi ndjehen më pak të sigurt në transportin publik dhe në sheshet, shtigjet e ecjes dhe korsitë për biçikleta. Përkatësisht, 19% të njerëzve në rajonin e Shkupit dhe 17% në pjesën Verilindore ndjehen të pasigurt në transportin publik, në krahasim me rajonet e tjera që shkojnë nga 1% deri në 9%. Gjithashtu, 64% të të rinjve në rajonin Lindor nuk ndjehen as të sigurt as të pasigurt. Në lidhje me sheshet, shtigjet e ecjes dhe korsitë për biçikleta, 22% e njerëzve në rajonin Verilindor ndjehen të pasigurt në këto vende, krahasuar me rajonet e tjera që lëvizin nga 1% deri në 14%. Përveç kësaj, 66% e të rinjve në rajonin Lindor nuk ndjehen as të sigurt as të pasigurt.

"Ndodhi vitin e kaluar në dimër në lagjen time në Lisiçe, disa rrugë nuk kishin drita. Po kthehesha në shtëpi nga fakulteti, ishte shumë errësirë dhe nuk dija ku të shkoja, gjë që më shqetësoi, se nuk mund të kthehesha në shtëpi e sigurt."


Femër, 20 vjeçare (Shkup)

Shumica e maqedonasve, romëve dhe shumica e etnive të tjera ndihen të sigurt në transportin publik dhe në sheshe, në shtigjet e ecjes dhe korsitë për biçikleta. Edhe pse shumica e të anketuarve shqiptarë (47%) ndihen të sigurt në transportin publik dhe në vende të tjera publike (48%), 45% nuk ndihen të sigurt ose të pasigurt në transportin publik dhe 43% nuk ndihen të sigurt ose të pasigurt në vende të tjera publike.

Sipas intervistës me përfaqësuesin e Ministrisë së Punëve të Brendshme, çdo vit organizohen fushata për të rritur sigurinë në autobusë dhe në ambiente publike. Këto fushata përfshijnë, midis aktiviteteve të tjera, shpërndarjen e fletushkave me mesazhe për sjellje jo të dhunshme. Këto fushata shpesh lidhen me ngjarje specifike si fushatat për festimin e sigurt të maturës, fushatat për pasojat negative të përdorimit të fishekzjarreve (veçanërisht para Vitit të Ri), drejtimin e sigurt të makinës pa përdorur alkoool etj.

– Problemet më të mëdha aktuale të të rinjve

Mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive (51% e të anketuarve) dhe mungesa e mundësive për zhvillim (51%) janë problemet më të mëdha të të rinjve për momentin, pasuar nga papunësia dhe problemet ekonomike, të cilat përbëjnë problemin më të madh për 49% të të rinjve. Problemi më i madh me të cilin përballen vajzat e reja (54%) është mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive, ndërsa problemi më i madh për djemtë e rinj (49%) është mungesa e mundësive për zhvillim. Problemi më i madh për të rinjtë që jetojnë në qytete është mungesa e mundësive për zhvillim, ndërsa për ata që jetojnë në zonat rurale, probleme po aq të rëndësishme janë papunësia dhe problemet ekonomike, si dhe mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive.



Grafiku 9: Problemet më të mëdha

Analiza e të dhënave tregon se këto tri probleme dominojnë në analizën e përkatësisë etnike, shpërndarjes rajonale dhe grupmohës. Megjithatë, rëndësia e këtyre tri problemeve ndryshon si më poshtë:

Grafiku 31: Qëndrimet e të rinjve në lidhje me besimin ndaj njerëzve të tjerë


Gjegjësisht:

- Në studimin për nivelin e mbështetjes tek të rinjtë, zbulohet se 91% e të anketuarve kanë një person të cilit i besojnë dhe të cilit do t'i drejtohen në situata problematike. Megjithatë, vetëm 77% e të rinjve shqiptarë kanë dikë në këtë rol, një numër që është më i ulët në krahasim me të rinjtë maqedonas, romë, turq, dhe komunitete të tjera. Në veçanti, një pjesë e konsiderueshme e të rinjve nga rajoni i Pollogut (20%) nuk kanë një person të tillë në këtë rol, duke u bërë ata më të kujdesshëm për këtë çështje krahasuar me grupet tjera.
- Sipas të dhënave, vetëm 10% e të rinjve nuk kanë një person të cilit mund t'i besojnë dhe të kontaktojnë nëse hasin në probleme. Megjithatë, një pjesë dukshëm më e madhe e të rinjve nga rajoni i Pellagonisë (21%) nuk ka asnjë person të tillë. Në fakt, 15% e të rinjve shqiptarë zgjedhin opsionin e njëjtë, që do të thotë që ata nuk kanë askënd të cilin mund t'i besojnë dhe t'i drejtohen nëse hasin në probleme. Në anën tjetër, 14% e të rinjve shqiptarë nuk dinë ose refuzojnë t'i përgjigjen pyetjes së cilit person mund t'i drejtohen nëse hasin në probleme.

- 85% e të rinjve të anketuar kanë njerëz me të cilët ndihen të afërt. Megjithatë, kjo përqindje është më e ulët në rajonet e Pellagonisë (76%) dhe Pollogut (72%), si dhe tek të rinjtë shqiptarë (71%).
- 82% e të rinjve kanë njerëz tek të cilët mund të mbështeten në kohë telashe. Megjithatë, kjo përqindje është më e ulët në rajonet e Pollogut (59%) dhe Jugperëndimor (72%), si dhe në mesin e të rinjve shqiptarë (70%).

– Qëndrimet për marrëdhëniet ndëretnike

Të anketuarit në studim u pyetën të vlerësonin pikëpamjet e tyre për njerëzit nga kulturat dhe etnitë e tjera. Të rinjtë kanë pikëpamje të ndryshme në lidhje me besimin e tyre të përgjithshëm të individët nga bashkësitë e tjera etnike. Në përgjithësi, 57% e tyre nuk besojnë tek njerëzit nga grupet të tjera etnike, ndërsa 43% e tjerë besojnë në individë të etnive të ndryshme.



Grafiku 32: Qëndrimet lidhur me besimin ndaj njerëzve të etnive të tjera.

Vajzat e reja (58%) kanë disi më pak besim te njerëzit e etnive të tjera krahasuar me djemtë e rinj (55%). Gjithashtu, të rinjtë në grupmoshën 15 - 18 vjeç (60%) kanë më pak besim se dy grupmoshat e tjera. Të rinjtë nga rajoni Jugperëndimor dhe rajoni i Pollogut kanë më pak besim te individët nga grupet etnike të tjera në krahasim me rajonet e tjera. Në anën tjetër, njerëzit nga Juglindja, Pellagonia dhe Verilindja shfaqin më shumë besim te individët e etnive të tjera. Shqiptarët (67%) shfaqin më pak besim në njerëz të etnive të tjera.

Sipas studimit rinor në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2018/2019 të realizuar nga Friedrich Ebert Stiftung¹⁸ "me siguri mund të vërtetohet se shtetasit maqedonas dhe shqiptarë në vitin 2018 besojnë njëri-tjetrit më pak se në vitin 2013".


62% e të rinjve nuk pajtohen me deklaratën "Ndihej i mbështetur nga njerëz të etnive të tjera". Mospajtimi me këtë pohim është më i pranishëm në grupmoshën 15 - 18 vjeç (65%) si dhe te të rinjtë nga rajoni Jugperëndimor (79%) dhe rajoni i Pollogut (80%) dhe te të rinjtë shqiptarë (71%).

Rezultatet për komunikimin me të rinj të feve/kulturave dhe besimeve të shumta janë të ngjashme. 61% e të rinjve nuk pajtohen me pohimin "Unë angazhohem rregullisht në biseda me njerëz të feve/kulturave dhe besimeve të shumfështa". Mospajtimi me këtë pohim është më i shprehur në grupmoshën 15 - 18 vjeç (68%) dhe tek të rinjtë shqiptarë (66%). Megjithatë, të rinjtë nga rajoni Verilindor (67% pajtohen me deklaratën) angazhohem rregullisht në komunikim me të rinjtë nga etnitë dhe kulturat e tjera në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre nga rajonet e tjera.

"Kisha një koleg maqedonas dhe biseda me të nuk po shkonte mirë. Kuptova se nuk mund të shoqërohesha me të."

Mashkull, 22 vjeçar (Tetovë)

Pothuajse pjesa e barabartë e të rinjve të anketuar vlerësojnë marrëdhëniet ndëretnike/ndërkomunitare si "as të mira as të këqija" (46%) dhe "të mira" (41%).



Grafiku 33: Vlerësimi i përgjithshëm i marrëdhënieve ndëretnike/ndërkomuniteteve

¹⁸ Studimi rinor në Republikën e Maqedonisë së Veriut 2018/2019, Friedrich Ebert Stiftung 2019.

45% e kategorisë së moshës 15 - 18 vjeç i konsiderojnë të mira marrëdhëniet ndëretnike/ndërkomunitare. Një pjesë më e madhe e të rinjve shqiptarë (52%) i konsiderojnë marrëdhëniet ndëretnike/ndërkomuniteteve si as të mira as të këqija në krahasim me maqedonasit (45%), serbët (42%), romët (36%), dhe etnitë e tjera. Të rinjtë nga rajoni i Shkupit, Verilindor dhe Lindor i shohin marrëdhëniet ndëretnike/ndërkomunitare më të këqija se bashkëmoshatarët e tyre nga rajonet e tjera.

- Besimi tek autoritetet

Të anketuarve në anketë iu kërkua të vlerësojnë besimin e tyre në institucionet publike në një shkallë nga 1 (aspak i besueshëm) deri në 4 (plotësisht i besueshëm). Në përgjithësi, besimi në autoritetet publike është përgjithësisht i ulët, duke filluar nga 1.6 deri në 2.2 në shkallë. Autoritetet publike vlerësohen në përgjithësi si "pak të besueshme". Tabela 3 tregon nivelet e besimit për institucionet e ndryshme.

#	Dukuritë	Mesatarja
1.	Kuvendi	1.7
2.	Qeveria	1.6
3.	Liderët e partive politike	1.6
4.	Policia	2.2
5.	Zyrtarët fetarë vendas	2.2
6.	Autoritetet më të larta fetare në fenë tuaj	2.2
7.	Institucionet shëndetësore në nivel lokal	2.1
8.	Institucionet shëndetësore në nivel kombëtar	2.1
9.	Gjykatat	1.7
10.	Komunat	2.0
11.	Organizatet ndërkombëtare	2.1
12.	Organizatet e shoqërisë civile	2.2

Tabela 3: Nivelet e besimit në institucione të ndryshme

Qeveria dhe liderët e partive politike (vlera mesatare = 1.6) konsiderohen më pak të besueshëm, ndjekur nga gjykatat dhe Kuvendi (vlera mesatare = 1.7). Në anën tjetër, më të besueshmet janë policia, udhëheqësit fetarë dhe organizatat e shoqërisë civile (vlera mesatare = 2.2).

"Doja të ndaja mendimin tim për institucionet shëndetësore pasi kam kryer shkollën e mesme mjekësore. Gjatë punës time praktike në këto institucione, nuk më ka pëlqyer qëndrimi i punonjësve ndaj pacientëve. Ata janë treguar gjithmonë jo të sjellshëm dhe të ngutshëm, duke iu kushtuar më shumë gjërave të tjera sesa kujdesit ndaj pacientëve. Kjo më shqetëson për sigurinë tonë si pacientë, si dhe për shëndetin tonë në përgjithësi".

Femër, 19 vjeçare (Shkup)

Kuvendi është më i besueshëm për të rinjtë nga rajoni i Pollogut, ndërsa më pak i besueshëm për të rinjtë e rajonit Verilindor.

Qeveria është më e besueshme për të rinjtë nga rajoni i Pollogut dhe më pak e besueshme për të rinjtë nga rajoni Lindor dhe Verilindor.

Liderët e partive politike janë më të besueshëm për të rinjtë nga rajoni i Pollogut dhe Vardarit dhe më pak të besueshëm për të rinjtë nga rajoni Lindor.

Policia është më e besueshme për të rinjtë nga rajoni i Vardarit dhe më pak e besueshme për të rinjtë nga rajoni Lindor.

Udhëheqësit fetarë lokal dhe liderët fetarë në nivel nacional janë më të besueshëm për të rinjtë e rajonit Juglindor dhe më pak të besueshëm për të rinjtë nga rajoni Verilindor.

Institucionet shëndetësore në nivel lokal dhe nacional janë më të besueshme për të rinjtë nga rajoni i Vardarit dhe më pak të besueshme për të rinjtë nga rajoni Lindor.

Gjykatat janë më të besueshmet për të rinjtë në rajonin e Vardarit dhe Pellagonisë dhe më pak të besueshme për të rinjtë nga rajoni Verilindor.

Pushteti lokal është më i besueshmi për të rinjtë e rajonit të Vardarit dhe më pak i besueshëm për të rinjtë nga rajoni i Pellagonisë.

Organizatata ndërkombëtare janë më të besueshmet për të rinjtë nga rajoni i Vardarit dhe Jugperëndimor dhe më pak të besueshme për të rinjtë nga rajoni Lindor.

Organizatata e shoqërisë civile janë më të besueshmet për të rinjtë nga rajoni i Vardarit dhe Verilindor dhe më pak të besueshme për të rinjtë nga rajoni i Lindjes dhe Pollogut.

Përfundime dhe rekomandime

- Të rinjtë në përgjithësi ndihen ambivalentë në lidhje me besimin te njerëzit e tjerë ose mendojnë se njerëzve nuk u besohet fare. Megjithatë, pjesa më e madhe e të rinjve kanë dikë kujt mund t'ju drejtohen në situata problematike, në telashe, ose dikë me të cilin mund të flasin dhe të ndihen rehat. Kjo ndjenjë e besimit dhe të pasurit dikë të afërt është më e ulët tek të rinjtë shqiptarë, si dhe tek të rinjtë nga rajoni i Pellagonisë dhe Pollogut.
- Qëndrimet për marrëdhëniet ndëretnike duket se janë përgjithësisht të njëjta dhe madje edhe më të këqija se në të kaluarën. Ashtu si në studimet e tjera, shumica e të rinjve nuk u besojnë njerëzve të etnive të tjera, nuk ndihen të përkrahur nga njerëzit e etnive të tjera, dhe nuk mund të angazhohen rregullisht në komunikim me njerëz të përkatësive të tjera kulturore dhe etnike. Përveç kësaj, kjo mungesë e besimit në etnitë e tjera është theksuar veçanërisht tek të rinjtë shqiptarë dhe tek femrat.
- Autoritetet publike në përgjithësi vlerësohen nga të rinjtë si "pak të besueshëm". Qeveria dhe liderët e partive politike janë më pak të besueshëm, ndjekur nga gjykatat dhe Kuvendi. Më të besueshmet janë policia, liderët fetarë dhe organizatat e shoqërisë civile.
- Të rinjtë nga rajoni i Pollogut në përgjithësi kanë një besim më të madh te Kuvendi, Qeveria dhe liderët e partive politike në krahasim me bashkëmoshatarët e tyre, ndërsa besimi i tyre te policia mungon.

Pas përfundimeve pasojnë rekomandimet, të cilat përfshijnë:

- Promovimi i vlerave si besimi dhe respekti reciprok, si dhe kultivimi i bashkëpunimit të mirë ndërkulturor dhe ndëretnik, duhet të bëhet imperativ për autoritetet dhe në të gjitha nivelet e shoqërisë. Të rinjtë duhet të dëshmojnë dhe të përjetojnë përfitimet e kultivimit të këtyre vlerave në realitet, dhe për të arritur këtë, përgjegjësia kryesore i takon autoriteteve.
- Autoritetet duhet të forcojnë dhe të zbatojnë më tej programe më thelbësore për bashkëpunim ndërkulturor dhe ndëretnik në nivel të shkollave dhe komuniteteve lokale. Shkëmbimi i thjeshtë i informacionit dhe mësimi i traditave dhe zakoneve nuk mjafton për të arritur qëllimet e përcaktuara.
- Ndarjet në bazë etnike në shkolla dhe institucione duhet të zvogëlohen, trajtohen sistematikisht dhe përfundimisht të eliminohen. Masat në këtë drejtim duhet të marginalizojnë ndikimin negativ të faktorit politik dhe të përforcojnë rolin e individëve dhe integritetin e tyre si imperativ në marrëdhëniet ndërpersonale dhe profesionale. Për të arritur këtë qëllim, partitë politike dhe shoqëria civile duhet të bashkëpunojnë në zbatimin e integritit multi-etnik dhe të shkojnë përtej demonstrimit të vullnetit drejt ndërmarrjes së veprimeve konkrete. Për më tepër, Ministria e Arsimit dhe Shkencës duhet të nxisë integrimin ndëretnik në shkolla dhe të krijojë kushte cilësore për komunikim të rregullt, mbështetje dhe ndërveprim mes nxënësve të të gjitha komuniteteve etnike.



6. SHQYRTIMI I LITERATURËS

1. Deklarata e OSBE-së për të Rinjtë, Këshilli i Ministrave, Vendimi nr. 3/14, Bazel.
2. Deklarata e OSBE-së për të Rinjtë dhe Sigurinë, Këshilli i Ministrave, Vendimi nr. 5/15, Beograd.
3. Deklarata e OSBE-së për rolin e të rinjve në kontributin e përpjekjeve për paqen dhe sigurinë, Këshilli i Ministrave, Vendimi nr. 18/3, Milano.
4. Rezoluta 2250 (2015) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
5. Rezoluta 2419 (2018) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
6. Rezoluta 2535 (2020) e Këshillit të Sigurimit të Kombeve të Bashkuara.
7. Ligji për Pjesëmarrjen e të Rinjve dhe Politikën Rinore (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 10/2020).
8. Ligji për parandalimin dhe mbrojtjen nga dhuna ndaj grave dhe dhuna në familje (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 24/2021).
9. Ligji për sportin (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 29/2002).
10. Ligji për familjen (tekst i konsoliduar, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale).
11. Ligji për mbrojtjen sociale (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 104/2019).
12. Ligji për mbrojtjen e fëmijëve (versioni i konsoliduar, Ministria e Punës dhe Politikës Sociale).
13. Ligji për drejtësi për fëmijët (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 66/24).
14. Ligji për arsimit fillor (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 169/19 dhe 229/20) dhe Udhëzuesi për procedurën për raportimin dhe mbrojtjen e nxënësve-viktimave të Dhunës.
15. Ligji për arsimit të mesëm (tekst i konsoliduar, Ministria e Arsimit dhe Shkencës).
16. Strategjia nacionale për të rinj 2023 – 2027 me Planin nacional të veprimit 2023 – 2025 (Gazeta Zyrtare e RMV-së, nr. 204/23).
17. Strategjia Nacionale e Republikës së Maqedonisë së Veriut për Luftimin e Terrorizmit (2023 - 2027) dhe Strategjia Nacionale për Parandalimin e Ekstremizmit të Dhunshëm (2023 - 2027) https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/nacionalna_strategjia_sne_2023-2027.pdf dhe https://vlada.mk/sites/default/files/dokumenti/nacionalna_strategjia_bpt_2023-2027.pdf.

18. Strategjia Kombëtare për Parandalimin dhe Mbrojtjen e Fëmijëve nga Dhuna (2020 - 2025) dhe Plani i Veprimit (2020 - 2022) <https://www.mtsp.gov.mk/dokumenti.nspk>.
19. Strategjia Nacionale për Parandalim dhe Drejtësi për Fëmijët në Republikën e Maqedonisë së Veriut (2022 - 2027) dhe Plani i Veprimit (2022 – 2027): <http://dspdp.com.mk/vesti/promocija-na-nacionalnata-strategjia-za-prevencija-i-pravda-za-decata-2022-2027/>.
20. Roli i Shoqërisë Civile në Parandalimin dhe Kundërshtimin e Ekstremizmit të Dhunshëm dhe Radikalizimit që shpie drejt Terrorizmit: Një Udhëzues për Evropën Juglindore, OSBE, në dispozicion në: https://www.osce.org/files/f/documents/8/d/411689_0.pdf.
21. Ministria e Punëve të Brendshme, Strategjia për Përfshirje dhe Komunikim me Komunitetin 2024 – 2026, në dispozicion në: https://mvr.gov.mk/Upload/Editor_Upload/strategji/Strategjia%20komunikacija_PO684887.pdf.
22. “#SharedFutures- Perceptimet e të rinjve për paqen në Ballkanin Perëndimor”, UNDP 2021, në dispozicion në: <https://www.undp.org/eurasia/publications/shared-futures-youth-perceptions-peace-western-balkans>.
23. “Të drejtat e fëmijëve në shkollat tona”, Fondacioni për Iniciativa Arsimore dhe Kulturore “Hap pas Hapi” dhe Avokati i Popullit, 2023 në dispozicion në: https://www.stepbystep.org.mk/WEBprostor/priracnici/IZVRSNO_REZIME_ISTRAZUVANJE_ZA_PRAVATA_NA_DECATA_MKD.pdf.

7. ANEKSET

7.1 PYETËSOR

Pjesa A - Demografia

A1 Gjinia	1. Mashkull 2. Femër 3. Tjetër 3. Nuk dëshiron të përgjigjet
A2 Kategoria e moshës	1. 15 - 18 2. 19 - 24 3. 25 - 29
A3 Arsimi më i lartë i përfunduar	1. Arsimi fillor 2. Arsimi i mesëm 3. I lartë 4. Diplomë Master 5. Doktoraturë 6. Nuk ka arsim formal
A4 Cila është përkatësia juaj etnike?	1. Maqedonase 2. Shqiptare 3. Turke 4. Rome 5. Serbe 6. Vllahe 7. Boshnjake 8. Tjetër (ju lutemi specifkoni): _____
A5 Me kë jetoni aktualisht?	1. Vetëm 2. Me të dy prindërit 3. Me nënën time 4. Me babin tim 5. Me partnerin apo bashkëshortin/en tim/e 6. Me miqtë/të afërmit 7. Dikë tjetër, kë? 8. Nuk kam përgjigje

A6 Cili është statusi juaj aktual i punësimit?		Anketues		
	A6.1 I/e punësuar me orar të plotë	1		
	A6.2 I/e punësuar me orar të pjesshëm	2		
	A6.3 Punoj në mënyrë të pavarur / free-lance	3		
	A6.4 I/ e papunë	4		
	A6.5 Nxënës	5		
	A6.6 Student	6		
	A6.7 Punëtor bujqësor	7		
	A6.8 Pronar i kompanisë	8		
A6.9 Tjetër	9			
A7 Cila është feja juaj?	1. Katolik 2. Ortodoks 3. Islam 4. Protestant 5. Hebre	6. Kopt 7. Unë jam ateist/e 8. Nuk kam fe 9. Të tjera 10. Nuk dua të përgjigjem		

Pjesa B - Perceptimi i sigurisë

B1 Cili është problemi më i madh me të cilin po përballeni tani?		Po	Jo	ND/NP
	1) Papunësia apo problemet ekonomike	1	0	99
	2) Mungesa e aktiviteteve kulturore dhe sportive	1	0	99
	3) Nuk ndihem i sigurt në komunitetin / vendin ku jetoj	1	0	99
	4) Nuk kam mundësi të mjaftueshme zhvillimi	1	0	99
	5) Më mungon mbështetja nga mjedisi	1	0	99
6) Nuk mund të ndikoj në jetën time personale	1	0	99	

B2 Sipas jush, cila është siguria aktuale në vend? Ju lutemi vlerësoni në një shkallë ku 1 paraqet - nuk është aspak e sigurt dhe 5 është plotësisht e sigurt	1) Nuk është aspak e sigurt 2) Nuk është e sigurt 3) As e sigurt dhe as e pasigurt 4) Disi e sigurt 5) Plotësisht e sigurt
B3 Çfarë mendoni se do të ndodhë me sigurinë në vend në pesë vitet e ardhshme?	1) Do të bëhet më mirë 2) Do të përqeshohet 3) Do të mbetet e njëjtë

B4 Deri në çfarë mase/shkalle ndiheni të sigurt...	I / e sigurt	As i sigurt, as i pasigurt	I/ e pasigurt
... në lagjen tuaj?	3	2	1
... në zonën/ qytetin/ tuaj?	3	2	1
... në vendin/ shtetin tuaj?	3	2	1
... në hapësirën digjitale?	3	2	1
... në transportin publik?	3	2	1
... në vende publike (të tilla si sheshe, shtigje për ecje dhe korsi për biçikleta)?	3	2	1

B5 Sa jeni të shqetësuar për këto dukuri? Notat mesatare (1: aspak i shqetësuar, 10: jashtëzakonisht i/e shqetësuar).	1) Grupet e sportdashësve që ndonjëherë janë të dhunshëm 2) Dhuna në familje 3) Gjuha e urrejtjes 4) Siguria në internet (siguria kibernetike) 5) Ardhja e migrantëve dhe refugjatëve 6) Terrorizmi ndërkombëtar 7) Grupet ultranacionaliste 8) Krimi i organizuar 9) Mundësia e shpërthimit të një konflikti të armatosur në vend 10) Mundësia e shpërthimit të një konflikti të armatosur brenda Ballkanit Perëndimor 11) Fatkeqësitë natyrore
---	--

Pjesa C - Pjesëmarrja në proceset formale dhe joformale të paqes

C1 Si do ta vlerësonit njohurinë tuaj për konceptin e ndërtimit të paqes? Ju lutemi vlerësoni në një shkallë nga 1 deri në 5 ku 1 do të thotë "aspak i/e njoftuar" dhe 5 do të thotë "plotësisht i/e njoftuar me ndërtimin e paqes".	1) Nuk jam fare i/e njoftuar 2) Nuk jam i/e njoftuar 3) Unë nuk jam as i/e njoftuar dhe as i/e panjofuar 4) Jam disi i/e njoftuar 5) Jam plotësisht i/e njoftuar
--	--

C2 A keni qenë vullnetar në 12 muajt e fundit në një aktivitet/iniciativë/aksion që promovon paqen dhe sigurinë?

- Po
- Jo

	Po	Jo	ND/NP
C3 (Nëse përgjigja është po për C2) Në cilat aktivitete/ iniciativa/veprime keni qenë vullnetar/e?			
1) Ngjarje sportive	1	0	99
2) Aktivitete kulturore	1	0	99
3) Nisma për promovimin e të drejtave demokratike	1	0	99
4) Aktivitete arsimore formale dhe joformale	1	0	99
5) Aktivitete fetare	1	0	99
6) Protestat civile	1	0	99
7) Eko aksione	1	0	99
8) Aktivitetet politike	1	0	99

C4 Në 12 muajt e fundit, a keni dëgjuar për aktivitetet e autoriteteve në lidhje me ndërtimin e paqes dhe sigurisë së të rinjve?

- Po
- Jo

	Aktorët	Renditja
C5 Sipas jush, kush në shoqëri është i angazhuar kryesisht në ndërtimin e paqes? Ju lutemi zgjidhni 3 më të rëndësishmet.	Qytetarët	1
	Institucionet shtetërore	2
	Pusheteti vendor	3
	Organizatrat civile	4
	Biznesi	5
	Organizatrat fetare	6
	Partitë politike	7

Pjesa D - Kundërvënja ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit

D1 A mendoni se radikalizimi është një problem/ problem kryesor në komunitetin tuaj?	0) Jo, nuk është problem 1) Po, është një problem 2) Është problemi më i rëndësishëm në komunitetin tim
--	---

D2 Cilët janë shtytësit më të rëndësishëm të radikalizimit? Ju lutemi zgjidhni 3 më të rëndësishmet.	1) Politika
	2) Ekonomia
	3) Feja/Religjioni
	4) Pabarazitë territoriale
	5) Dinamika transnacionale
	6) Kultura dhe koha e lirë
	7) Hapësira digjitale
	8) Praktikat diskriminuese

D3 Deri në çfarë mase jeni dakord me pohimet e mëposhtme?	Nuk jam aspak dakord	Deri diku nuk jam dakord	Deri diku jam dakord	Jam plotësisht dakord
	1	2	3	4
1) Unë do të ndaloja çdo komunikim me një shok/koleg nëse do të vëreja ndonjë shenjë radikalizimi.				
2) Kam frikë të flas me njerëz që janë dënuar për aktivitete terroriste dhe/ose ekstremizëm të dhunshëm.				
3) Kam frikë të jetoj pranë njerëzve që janë dënuar për aktivitete terroriste dhe/ose ekstremizëm të dhunshëm.				
4) Do të mbështesja një iniciativë për risocializimin e personave të përfshirë në aktivitete terroriste.				

D4 Cilët nga aktorët e mëposhtëm kanë rolin më të fortë për kundërvënien ndaj ekstremizmit të dhunshëm dhe radikalizimit: Ju lutemi zgjidhni maksimumi 3 përgjigje.	1) Organizatat civile
	2) Udhëheqësit fetarë
	3) Përfaqësuesit e shkollave
	4) Anëtarët e bashkësive lokale
	5) Shërbimet e sigurimit - policia
	6) Qendrat për punë sociale
	7) Organizatat ndërkombëtare

D5 Cilët janë faktorët më të rëndësishëm për kundërvënien ndaj radikalizimit: Ju lutemi zgjidhni 3 përgjigje.	1) Të drejtat dhe përfaqësimi politik
	2) Mundësitë ekonomike dhe punësimi
	3) Feja
	4) Shpërndarja e barabartë e shërbimeve dhe e pasurisë në një shtet
	5) Lufta kundër dezinformimit
	6) Ofrimi i mundësive për dialog kulturor dhe hapësira rekreative
	7) Rritja e sigurisë në hapësirën digjitale

Pjesa E - Dhuna mes të rinjve

E1 Sipas jush, sa është e pranishme sjellja e dhunshme tek të rinjtë? Ju lutemi vlerësoni në një shkallë ku 1 është plotësisht e pranishme dhe 5 nuk është fare e pranishme.	1) Plotësisht e pranishme
	2) Deri diku e pranishme
	3) As e pranishme dhe as e papranishme
	4) Jo e pranishme
	5) Nuk është fare e pranishme

E2 Sipas jush, cilat janë tre arsyt kryesore që i motivojnë të rinjtë të ndër marrin veprime të dhunshme?	1) Zhgënjim me statusin e tyre shoqëror
	2) Përfshirja nga proceset vendimmarrëse
	3) Mungesa e mbështetjes nga institucionet në jetën e përditshme
	4) Mungesa e mundësive për karrierë
	5) Ideologjia radikale
	6) Motivet fetare
	7) Ndjenja e padrejtësisë
	8) Mungesa e mbështetjes familjare
	9) Izolimi nga miqtë

E3 Në 12 muajt e fundit, a keni përjetuar apo dëshmuar ndonjë lloj dhune?

1. Po, kam përjetuar dhe dëshmuar
 2. Po, kam përjetuar
 3. Po, kam qenë dëshmitar/e
 4. Jo, nuk e kam përjetuar apo dëshmuar
- 98) Refuzon të përgjigjet [MOS E LEXO]
99) Nuk e di [MOS E LEXO]

	Lloji dhunës	Po	Jo	ND/NP
E4 Nëse përgjigja është po, në E3, ju lutemi përgjigjuni se çfarë lloj dhune keni parë dhe/ose përjetuar:	1) Dhunë fizike	1	0	99
	2) Dhunë verbale	1	0	99
	3) Dhunë sociale	1	0	99
	4) Dhunë psikike	1	0	99
	5) Ngacmim/dhunë kibernetik/e	1	0	99
	6) Dhunë seksuale	1	0	99

	Vendndodhja e dhunës	Po	Jo	ND/NP
E5 Nëse përgjigja është po, në E4, ju lutemi përgjigjuni se ku keni përjetuar ose qenë dëshmitarë të dhunës.	1) Në shtëpi	1	0	99
	2) Në shkollë	1	0	99
	3) Spital	1	0	99
	4) Park	1	0	99
	5) Rrugë	1	0	99
	6) Kafene ose klub	1	0	99
	7) Vend parkimi	1	0	99
	8) Vend/kënd i errët	1	0	99
	9) Stacion i policisë	1	0	99
	10) Në shtëpinë e një miku/mikeshe	1	0	99
	11) Zyrë	1	0	99
	12) Online	1	0	99
	13) Tjetër			

Pjesa F - Ngacmimi kibernetik - Bullizmi kibernetik

F1 Sa i /e sigurt ndiheni kur përdorni internetin? Ju lutemi vlerësoni në një shkallë ku 1 nuk është aspak e sigurt dhe 5 është plotësisht e sigurt	1) Nuk është aspak i/e sigurt
	2) I/e pasigurt
	3) As i/e sigurt dhe as i/e pasigurt
	4) I/e sigurt
	5) Plotësisht i/e sigurt

F2 Në një shkallë nga 1 deri në 5 ku 1 do të thotë nuk i kushtoj vëmendje fare, ndërsa 5 do të thotë i kushtoj shumë vëmendje, sa vëmendje i kushtoni mbrojtjes së të dhënave tuaja personale në internet?	1) Nuk i kushtoj vëmendje fare
	2) Nuk i kushtoj vëmendje
	3) I kushtoj vëmendje dhe nuk i kushtoj shumë vëmendje
	4) I kushtoj vëmendje
	5) I kushtoj shumë vëmendje
	6) Nuk e di / Refuzon të përgjigjet [MOS E LEXO]

F3 A keni përjetuar ndonjëherë një situatë ku të dhënat, fotot ose videot tuaja janë përdorur në internet pa pëlqimin tuaj?

1. Po
 2. Jo
- Nuk më ka ndodhur, por njoh dikë që i ka ndodhur

F4 A keni përjetuar ndonjëherë ngacmim kibernetik?

1. Po
2. Jo

F5 Nëse keni përjetuar ngacmime kibernetike në internet, ku ka ndodhur:

1. Mesazhe të çastit (Viber, WhatsApp, Telegram, Signal)
2. Email
3. Facebook
4. Instagram
5. YouTube
6. TikTok
7. Tjetër _____

F6 Ku do ta raportoni bullizmin kibernetik për abuzim të të dhënave dhe përmbajtjes suaj personale?

1. Familja
2. Shkolla/Fakulteti
3. Miqtë
4. Organizatat civile
5. Policia
6. Agjencia për Mbrojtjen e të Dhënave Personale
7. Avokati i Popullit
8. Nuk do të raportoj

Pjesa G - Përgjashtimi dhe Diskriminimi

G1 Ju lutemi zgjidhni dy (2) arsye më të zakonshme të përgjashtimit/diskriminimit social që ndodhin midis të rinjve në vend (ANK. Lexoni opsionet e dhëna)

Bazat/Arsyet për diskriminim	Arsyeja e parë e diskriminimit	Arsyeja e dytë e diskriminimit
Përkatësia etnike	1	1
Feja	2	2
Gjinia	3	3
Orientimi seksual	4	4
Përkatësia politike	5	5
Gjendja ekonomike	6	6
Aftësia e kufizuar	7	7
Mosha	8	8
Tjetër, çfarë _____	9	9
Nuk e di / Refuzon (ANK nuk lexon)	10	10

G2 A keni përjetuar personalisht diskriminim apo jeni ndër të diskriminuar?

1. Po
2. Jo
3. Refuzon të përgjigjet

G3 Për çfarë arsye u ndjetë i / e diskriminuar?

1. Përkatësia etnike
2. Feja
3. Gjinia
4. Orientimi seksual
5. Përkatësia politike
6. Gjendja ekonomike
7. Aftësia e kufizuar
8. Mosha
9. Të tjera, çfarë _____
10. Nuk e di / Refuzon të përgjigjet (ANK: mos e lexo)

G4 A keni bërë ndonjëherë ankesë pranë institucioneve (si Avokati i Popullit dhe Komisioni për Parandalimin e Diskriminimit)?

1. Po
2. Jo

G5 Deri në çfarë mase jeni dakord me pohimet e mëposhtme?	Nuk jam aspak dakord	Deri diku nuk jam dakord	Deri diku jam dakord	Plotësisht jam dakord
	1	2	3	4
1) Jam i/e informuar për proceset e vendimmarrjes në komunën/komunitetin/vendin tim ku jetoj				
2) Jam i/e përfshirë në proceset vendimmarrëse në komunën/komunitetin/vendin tim ku jetoj				
3) Mund të ndikoj në vendimet në komunën/komunitetin/vendin tim ku jetoj				
4) Jam i/e informuar për proceset e vendimmarrjes në mjedisin tim të punës/shkollës				
5) Jam i/e përfshirë në proceset vendimmarrëse në mjedisin tim të punës/shkollës				
6) Mund të ndikoj në vendimet në mjedisin tim të punës/shkollës				
7) Unë jam pjesë e vendimeve të marra brenda rrjetit tim social/grupit të miqve				
8) Mund të ndikoj në vendimet brenda rrjetit tim social/grupit të miqve				

Pjesa H - Besimi tek autoritetet dhe njerëzit e tjerë dhe marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve

H1 Në përgjithësi, do të thoshit se shumicës së njerëzve mund t'u besohet? Ju lutem më tregoni në një shkallë nga 1 deri në 5, ku 1 do të thotë se njerëzve nuk mund t'u besohet fare dhe 5 do të thotë se shumicës së njerëzve mund të besohet.	1) Njerëzve nuk mund t'u besohet fare 2) Nuk mund t'u besohet njerëzve 3) Njerëzve as nuk mund t'u besohet, as mos t'u besohet 4) Njerëzve mund t'u besohet 5) Shumicës së njerëzve mund t'u besohet
--	--

H2 Si ndiheni për deklaratat e mëposhtme në lidhje me mbështetjen që merrni nga të tjerët?		Po	Jo	ND/NP
	Unë kam dikë të cilit i besoj dhe të cilit do t'i drejtohesha për këshilla nëse do të kisha probleme.	1	0	99
	Nuk ka njeri me të cilin ndihem rehat të flas për problemet	1	0	99
	Nuk kam askënd me të cilin ndihem afër	1	0	99
Ka njerëz tek të cilët mund të mbështetem në kohë të vështira	1	0	99	

H3 Deri në çfarë mase jeni dakord me pohimet e mëposhtme?	Nuk jam aspak dakord	Deri diku nuk jam dakord	Deri diku jam dakord	Plotësisht jam dakord
	1	2	3	4
1) Në përgjithësi u besoj njerëzve të etnive të tjera				
2) Ndihem i mbështetur nga njerëz të etnive të tjera				
3) Unë angazhohem rregullisht në biseda me njerëz nga fe/kultura dhe besime të shumta				
4) Ndjej se zëri im dëgjohet kur kam të bëj me Qeverinë dhe autoritetet				

H4 Sa të besueshme i konsideroni institucionet/autoritetet e mëposhtme?	Aspak i / e besueshëm / me	Pak i / e besueshëm / me	Mesatarisht i / e besueshëm / me	Plotësisht i / e besueshëm / me
	1	2	3	4
1) Kuvendi				
2) Qeveria				
3) Drejtuesit e partive politike				
4) Policia				
5) Zyrtarët fetarë lokal				
6) Autoritetet më të larta fetare në fenë tuaj				
7) Institucionet shëndetësore në nivel lokal				
8) Institucionet shëndetësore në nivel shtetëror				
9) Gjykatat				
10) Komunitat				
11) Organizatat ndërkombëtare				
12) Organizatat qytetare				

H5 Si i vlerësoni marrëdhëniet ndëretnike ndërmjet komuniteteve dhe vendeve?

1. Të shkëlqyera
2. Të mira
3. As të mirë as të këqija
4. Të këqija
5. Shumë të këqija

7.2 UDHËZUES PËR DISKUTIM PËR FOKUS GRUPET

Ju lutemi lexoni dhe shpjegoni pyetjet në një gjuhë të thjeshtë që mund të kuptohet nga një i ri dhe kini kujdes për përbërjen e grupit. Shpjegoni pyetjet nëse është e nevojshme, por shmangni ndikimin/ludhëheqjen e përgjigjeve të pjesëmarrësve dhe ofrimin e interpretimit tuaj të një pyetjeje.

Ju lutemi sigurohuni që pjesëmarrësve të mos u kërkohet ose të hetohet të zbulojnë detaje personale, konfidenciale ose intime rreth jetës së tyre dhe që të gjithë të rinjtë e pranishëm të marrin pjesë në diskutim. Megjithatë, mos angazhoni askënd drejtpërdrejt dhe mos i detyroni të përgjigjen.

Hyrje:

Indago Doel Skopje për qëllime të Misionit të OSBE-së në Shkup (OSBE) po kryen hulumtim për të rinjtë dhe sigurinë në Maqedoninë e Veriut. Qëllimi është të shihet perceptimi i të rinjve për sigurinë nëse ata marrin pjesë në proceset formale dhe joformale të paqes, si dhe të diskutohen çështjet e luftimit dhe parandalimit të ekstremizmit të dhunshëm në vend. Për më tepër, OSBE-ja dëshiron të mësojë më shumë për dhunën, përjashtimin dhe marginalizimin e të rinjve në të gjitha nivelet, si dhe besimin në autoritetet dhe marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve në dekadat e fundit.

Do të ishim shumë mirënjohës nëse do t'i përgjigjesht pyetjeve për ne. Është anonim, me fjalë të tjera, askush nuk do t'i dijë përgjigjet tuaja. Nuk ka përgjigje të sakta apo të gabuara, ne jemi të interesuar vetëm të dimë zgjedhjet, opinionet dhe ndjenjat tuaja. Diskutimi i fokus grupit është konfidencial (ne nuk do të kërkojmë emrin tuaj dhe nuk do të kalojmë asnjë informacion që na jepni).

Pjesa 1: Perceptimet e sigurisë, përfshirja në aktivitetet e paqes dhe sigurisë

Në fillim, ne do të dëshirojmë të dëgjojmë nga ju për përvojat tuaja vullnetare (nëse keni) ose për pjesëmarrjen tuaj në aktivitete të ndryshme të organizuara nga disa klube, organizata ose ndoshta shkolla/fakulteti.

(Diskutimi duhet të nxjerrë në pah se sa aktivë janë të rinjtë jashtë aktiviteteve të tyre të rregullta shkollore, fakultetit apo punës. Vullnetarizmi dhe aktivizmi merrin si parakushte për të vlerësuar interesin dhe potencialin e të rinjve për kontribut dhe qytetari aktive. Kjo hapje do të ofrojë më shumë informacion specifik mbi përvojën e të rinjve me vullnetarizmin, nëse e kuptojnë termin vullnetarizëm, nëse marrin pjesë në ndonjë aktivitet vullnetar dhe të çfarë lloji. Të rinjtë që nuk kanë përvojë vullnetarizmi do të ndajnë informacion mbi aktivizmin e tyre në përgjithësi, ndoshta anëtarësimin e tyre në disa organizata apo në klube sportive.)

A mund të na tregoni për disa veprime paqeje dhe sigurie që janë zbatuar në komunitetin ose qytetin tuaj, në të cilat keni marrë pjesë, në të cilat keni qenë të informuar? Cila ishte përvoja juaj dhe cilat ishin efektet?

(Diskutimi duhet të nënvizojë veçanërisht veprime specifike (nëse ka) të ndërmarra në nivelin e komunitetit/qytetit lidhur me paqen dhe sigurinë, preferencat dhe pakënaqësitë e pjesëmarrësve për këto aktivitete, përvojat e pjesëmarrësve me këto veprime, kush mori pjesë, perceptimet dhe përvojat me organizatorët, a ndjehen ata të besueshëm në lidhje me këtë lloj aktivitete, a kanë nevojë për më shumë aktivitete të këtij lloji ose ndoshta kanë njohuri shumë të vogla në lidhje me temën e paqes dhe sigurisë.)

Ju lutemi na përshkruani shqetësimet tuaja të sigurisë. Shqetësimet që keni mund të lidhen me shkollën, fakultetin ose mjedisin tuaj të punës. Përveç kësaj, ju mund të dëshironi të ndani shqetësimet e sigurisë që lidhen me qytetin tuaj ose vendin në përgjithësi.

(Diskutimi duhet të nxjerrë se sa të sigurt ndihen të rinjtë në mjedisin e tyre, përfshirë shkollën/fakultetin apo punën. Shqetësimet për sigurinë mund të zbulojnë lloje të ndryshme kërcënimesh që lidhen me sigurinë fizike, ose sjellje të dhunshme në mjedise të ndryshme si dhuna mes bashkëmoshatarëve, dhuna sociale, ose mobingu. Diskutimi duhet të sjellë gjithashtu informacion mbi perceptimin dhe opinionin e përgjithshëm të të rinjve se sa i sigurt është qyteti i tyre, si dhe cilat janë çështjet kryesore të sigurisë në vend nga perspektiva e të rinjve.)

Ju lutem, a mund të përshkruani nëse grupe të veçanta të rinjsh përjetojnë probleme sigurie? Kush janë këto grupe dhe pse janë veçanërisht në rrezik?

(Diskutimi duhet të nxjerrë në pah nivelin e sigurisë së disa grupeve specifike të të rinjve, si LGBTI, romët dhe të tjerët, si dhe arsytet dhe kushtet që lidhen me sigurinë e tyre.)

Ju lutem, a mund të përshkruani aktivitetin digjital të të rinjve në mjedisin tuaj? Cilat janë rrjetet dhe aplikacionet sociale më të njohura? Çfarë lloj shqetësimesh sigurie për ju dhe miqtë tuaj ngrenë rrjetet sociale dhe komunikimin në hapësirën digjitale?

(Diskutimi duhet të nxjerrë në pah cilat janë rrjetet sociale dhe llojet e komunikimit më të njohura në hapësirën digjitale dhe sa të sigurt janë ato. Diskutimi duhet gjithashtu të tregojë nivelin e informimit të të rinjve për shqetësimet e mundshme të sigurisë në hapësirën digjitale dhe nëse ata i njohin dhe identifikojnë kërcënimet e mundshme të sigurisë.)

Pjesa 2: Diskriminimi, polarizimi politik, përjashtimi, dhuna

A mund të përshkruani ndonjë diskriminim apo polarizim politik në shkollën/fakultetin apo mjedisin tuaj të punës? Cilat janë arsytet për këtë dhe kush po i ndërmerr këto praktika diskriminuese? Cilat ishin pasojat negative dhe nëse dikush bëri diçka për të ndihmuar në këto situata?

(Diskutimi duhet të nxjerrë në pah nëse ata ose miqtë e tyre kanë përjetuar incidente negative, bazuar në diskriminim mbi baza etnike, gjinore, politike apo të tjera, çfarë ndodhi që çoi në këto situata dhe çfarë ndodhi më pas.)

Sa shpesh debaton me prindërit, vëllanë/motrën/partnerin? Çfarë bëni në atë situatë dhe çfarë bëjnë ata? Si i zgjidhni këto grindje?

(Diskutimi duhet të nxjerrë në pah nëse pjesëmarrësit kanë përvojë të drejtpërdrejtë me dhunën në familje, sa shpesh, si manifestohet dhe a zgjidhet në ndonjë mënyrë.)

Sa shpesh debaton me shokët apo kolegët tuaj? Çfarë bëni në atë situatë dhe çfarë bëjnë ata? Si i zgjidhni këto mosmarrëveshje dhe grindje?

(Diskutimi duhet të nxjerrë në pah nëse pjesëmarrësit kanë përvojë të drejtpërdrejtë me dhunën mes bashkëmoshatarëve, sa shpesh ndodh, si manifestohet dhe a zgjidhet në ndonjë mënyrë.)

Cilat janë mekanizmat që ju dhe miqtë tuaj mund të përdorni për të reaguar në situata të dhunës, diskriminimit ose shqetësimeve të sigurisë? A keni raportuar ndonjëherë një sjellje të tillë në disa prej këtyre mekanizmave dhe cila ishte përvoja juaj? A mund t'u besoni këtyre mekanizmave?

(Diskutimi duhet të nxjerrë në pah se sa të informuar janë të rinjtë për mekanizmat ekzistues për luftimin e diskriminimit, dhunës dhe kërcënimeve të tjera të sigurisë dhe sa funksionale janë

këto mekanizma. Përveç kësaj, diskutimi do të ofrojë informacion mbi besueshmërinë e këtyre mekanizmave dhe, nëse jo, pse nuk besojnë).

Pjesa 3: Radikalizimi, ekstremizmi i dhunshëm, marrëdhëniet ndërmjet komuniteteve

Ju lutem, a mund të përshkruani ndonjë situatë apo përvojë kur ju ose disa nga miqtë tuaj keni qenë në kontakt ose nën kërcënimin e sigurisë nga disa grupe radikale, çështje ose informacione që lidhen me radikalizimin dhe ekstremizmin e dhunshëm? A i keni raportuar ju apo dikush tjetër këto raste dhe kujt? Nëse jo, pse?

(Diskutimi duhet të nisë duke nxjerrë në pah nëse të rinjtë kuptojnë termat e radikalizimit dhe ekstremizmit të dhunshëm. Pastaj, diskutimi mund të zbulojë disa raste specifike të përvojave personale të radikalizimit ose situata të dëshmuara dhe të ofrojë informacion mbi atë se si ndodhi kjo, çfarë ishin pasojat dhe çfarë u bë (nëse diçka) për të parandaluar situata të mëtejshme të këtij lloji.)

Si ndiheni për bashkëpunimin, mësimin dhe punën me njerëz me prejardhje të ndryshme etnike ose fetare nga tuajat? Sa shpesh takoni të rinj me prejardhje të ndryshme etnike dhe si do ta përshkruanit komunikimin tuaj të ndërsjellë?

(Diskutimi duhet të zbulojë nëse të rinjtë besojnë bashkëmoshatarët e tyre ose bashkëpunëtorët nga sfondet etnike të ndryshme dhe nëse jo, çfarë janë arsyet për këtë. Gjithashtu, diskutimi duhet të nxjerrë në pah nëse të rinjtë ndihen të sigurt apo të kërcënuar në komunikimin me njerëz nga sfondet etnike të ndryshme).

Pjesa 4: Besimi tek institucionet dhe komuniteti

Ju lutem a mund të përshkruani sjelljen tuaj në institucionet publike? Si ndiheni kur shkoni në institucione për të kërkuar ndonjë shërbim apo për të kërkuar informacion?

(Diskutimi duhet të ofrojë informacion mbi atë se si pjesëmarrësit vepruan në komunikimin me institucionet, se sa të sigurt ndihen dhe nëse besojnë në institucionet.)

Si do ta përshkruanit komunikimin e punonjësve në institucionet publike me qytetarët? Çfarë është e mirë dhe çfarë mund të përmirësohet? Cilët janë faktorët më të rëndësishëm për të rritur besimin e të rinjve tek institucionet?

(Diskutimi duhet të ofrojë informacion mbi mënyrën se si administrata publike përmbush detyrat dhe rolin e saj dhe për disa propozime mbi atë se si kjo mund të përmirësohet për të shërbyer më mirë nevojat e të rinjve.)

Pjesa 5: Rekomandime nga pjesëmarrësit

Çfarë do të thotë një jetë dhe mjedis i sigurt për të rinjtë në Maqedoninë e Veriut?

Si mund të përmirësohet siguria për të kënaqur nevojat e të rinjve?

Cila mund të jetë sfida më e madhe në ndërtimin e një shoqërie më të sigurt për të rinjtë?

Çfarë mund të përshpejtojë ndërtimin e një shoqërie më të sigurt për të rinjtë?

